



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Nr. 02-060/01-0069482/24 dt. 22.10.2024**

**Mitrovicë**

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **mërkurën** më dt. **30.10.2024**:

### **T H Ë R R E T**

**Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës**  
**Seanca e 35-të**

Mbledhja do të ketë këtë:

#### **REND DITE:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim-vendim për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025
3. Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave
4. Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë për mbulimin e shpenzimeve të varrimit
5. Raporti financiar për periudhën janar-shtator 2024
6. Pyetje dhe përgjigje

**Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.**

**Mitrovicë**

**Kryesuesja e Kuvendit**

*Bronja*  
**Vesa BROJA**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0061628/24 dt. 23.09.2024

Mitrovicë

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 34-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

**Koha:** 31.07.2024 ora 10:00

**Vendi:** Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

**Të pranishëm:** Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Egzon Hamza, Lavdim Zeneli, Nafije Rexha, Mentor Vinarci, Hamdi Hasani, Faruk Mujka, Naser Muja, Armend Begu, Ekrem Sadiku, Shkurta Shosholli Musa, Elidiana Budini Haziri, Jeton Zeneli, Xhevrije Bahtiri Ademi, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Xhylljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj, Sevdaim Uka Gazmend Asllani, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Ardita Aliu, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Vesel Neziri

**Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza**

**Nënkryetari i Komunës z. Arian Tahiri**

**Drejtorët e Drejtorive**

**Përfaqësues të Shoqërisë Civile**

**Mediat**

**Mungoi:** Hysen Muzliukaj

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës ka thirrur mbledhjen e 34-të të rregullt të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja theksoi se si material shtesë të premtën, e keni pranuar edhe raportin e performancës komunale, Raportin e Drejtorisë Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë, si dhe informatën e Komisionit për vlerësime të dëmeve nga vërshimet, dhe propozoi që raporti i performancës komunale dhe raporti i DSHPI-së të hyjnë si pika të veçanta, ndërsa informatën mundem me e diskutu edhe te pika: pyetje përgjigje, nëse mendoni edhe jeni dakord edhe ju, dhe po hapi diskutimin për rend dite.

Xhafer Preteni: I nderuar Kryetar, Nënkryetar, Drejtor, të nderuar kolegë asamblastë, sekretari e nderuar, Kryesuese e kuvendit, para një muaji i keni pranuar tri kërkesa nga organizatat e dala nga lufta për subvencionim, kështu që kisha kërkuar nga ju që të futën në rend të ditës sot.

Kryesuesja e Kuvendit Vesa Broja: Është e vërtetë që i kam pranuar tri kërkesa nga organizatat e dala nga lufta për mbështetje financiare edhe të cilat normalisht, me pëlqimin tuaj mund ti fusim në rend dite edhe kërkoj nga Sekretaria e Kuvendit t'i përgatitë të gjitha kërkesat dhe m'i shpërnda për secilin anëtar të kuvendit, normalisht nëse futen në rend dite.

Faruk Mujka: Ne nuk kemi kurrë kundër për këtë çështje, mirëpo, veç po duam me ditë subvencionimi prej kahit ka me shkua, se e kemi diskutu për katër vite që subvencionet nga ana e Kuvendit janë të jashtëligjshme, kështu që në qoftë se shkon prej ndonjë drejtorie apo prej ndonjë Kodi Buxhetor, janë rregull, po Kuvendi nuk subvencionon edhe veç i mashtrojmë kot, se apat vjen përgjigje negative prej MAPL-së.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Po besoj që drejtorja e mirëqenies mundet me na jep përgjigje sa i përket buxhetit se a ka mundësi për ndarjen e këtyre mjeteve, pasi që si Kuvend nuk kemi subvencione.

Drita Ibrahim: Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka buxhet për me i subvencionuar edhe këtë kategori.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Faleminderit drejtoreshë, edhe marrë parasysh që sivjet nuk kanë qenë përfitues të subvencioneve, shumta të cilën e kanë kërkuar që të tri shoqatat i kanë kërku nga 3.300 €, ne po i fusim në rend të ditës, secilën veç e veç. Materiali ju vjen secilit prej juve dhe pastaj kur vjen pika e rendit të ditës, mundemi me diskutua. Dikush tjetër për rend dite? Nëse jo, atëherë kush është që të futet në rend dite Raporti i performancës komunale?

**Rezultati i votimit 32 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

Kryesuesja e konstatoi të miratuar me votë unanime që në rend dite si pikë e tetë të jetë Raporti i performancës komunale.

Kryesuesja: Kush është që në rend të ditës si pikë e dymbëdhjete të futet raporti i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë?

**Rezultati i votimit 31 për, 0 kundër dhe 1 abstenim.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar propozimin që në rend dite si pikë e dymbëdhjetë të jetë Raporti i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë.**

Kryesuesja: Kush është që të futet në rend dite kërkesa për mbështetje financiare e Shoqatës së invalidëve të luftës së UÇK-së?

**Rezultati i votimit 32 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar me votë unanime që në rend dite si pikë e nëntë të hyjë kërkesa për mbështetje financiare e Shoqatës së invalidëve të luftës së UÇK-së.**

Kryesuesja: Kush është që të futet në rend dite si pikë e dhjetë kërkesa për mbështetje financiare nga shoqata e familjeve të dëshmorëve të luftës së UÇK-së?

**Rezultati i votimit 32 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar me votë unanime që në rend dite si pikë e dhjetë të hyjë kërkesa për mbështetje financiare të shoqatës së familjeve të dëshmorëve të luftës së UÇK-së**

Kryesuesja: Kush është që të futet në rend dite si pikë e njëmbëdhjetë, kërkesa për mbështetje financiare e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

**Rezultati i votimit 32 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar me votë unanime që në rend dite si pikë e njëmbëdhjetë të hyjë kërkesa për mbështetje financiare të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së**

Kryesuesja: Hedh në votim rendin e ditës të plotësuar:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft Buxheti për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027
3. Propozim-Vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/060/01-0029209/21-3 i dt. 29.04.2021
4. Propozim-Vendim për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K.
5. Propozim-Vendim për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K. duke përfshi dhe objekti për banim/afarizëm
6. Propozim-vendim për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Blerim Emini
7. Propozim Vendim për miratimin e ndryshimit të emërimit të shkollave të mesme të larta profesionale në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional- IAAP
8. Raporti i Performancës Komunale për vitin 2023
9. Propozim vendim për mbështetje financiare të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së
10. Propozim vendim për mbështetje financiare të Shoqatës së familjeve të dëshmorëve të luftës së UÇK-së
11. Propozim vendim për mbështetje financiare të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së
12. Raporti i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë
13. Pyetje dhe përgjigje

**Rezultati i votimit: 32 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Rendi i ditës u miratua unanimisht.**

### **Pika 1**

Kryesuesja e Kuvendit Vesa Broja hapi diskutimin për Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

**Rezultati i votimit: 32 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht pa diskutim.**

### **Pika 2**

Kryesuesja para se ta hapë diskutimin lidhur me Draft Buxhetin për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Igballe Islami: Faleminderit e nderuara Kryesuese, Kryetar, Nënkryetar, të nderuar asambleistë, të nderuar drejtorë. Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj draft-buxhetin për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027. Komuna e Mitrovicës ka zhvilluar procesin e hartimit të draft-buxhetit për vitin 2025 dhe vlerësimet për 2026-2027 në harmoni të plotë me instruksionet e dhëna nga Ministria e Financave, punës dhe transfereve duke i respektuar kështu edhe qarkoret buxhetore 2025/1 dhe 2025/2, në harmoni edhe me Kornizën afatmesme buxhetore e cila është aprovuar në Kuvendin Komunal në qershor 2024. Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të marrjes së kërkesave dhe nevojave të qytetarëve ka organizuar edhe dëgjimet buxhetore ku janë mbajtur katër dëgjime buxhetore me qytetarët e Komunës së Mitrovicës të cilat janë pasqyruar edhe në raportin e dëgjimeve buxhetore i cili i është drejtuar kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive. Buxheti është i hartuar në përputhshmëri me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë kështu që qëllimi i tij ka qenë finalizimi dhe përmbushja e interesave të qytetarëve të komunës sonë me varshmëri aq sa kanë lejuar edhe kufijtë e limituar të financimit. Bazuar në komisionin e granteve, Komuna e Mitrovicës për vitin 2025 do të ketë buxhet në vlerë totale prej 30,240,514.00 € të shpërndarë në pesë kategori ekonomike: Nëse e krahasojmë buxhetin e vitit 2025 me buxhetin e vitit aktual kemi një rritje total prej 6.4% kjo rritje është reflektuar aty ku ka qenë edhe kërkesa e qytetarëve e nevojat e tyre që është në kategorinë e investimeve kapitale ku kemi rritje prej 13% referuar këtij viti. Kam kënaqësinë edhe jam shumë me fat që jemi në qeverisje ku prioritet është arsimit dhe kemi rritje në investime kapitale në drejtorinë komunale të arsimit prej 15.3% krahasuar me vitin aktual. Rritje në investime kapitale ka edhe në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë prej 27%, rritje kemi edhe në kategorinë për Mallra dhe Shërbime e cilat janë për inventarizimin e bibliotekës, inventarizimin e çerdheve. Ajo çfarë është e rëndësishme Drejtoria për Buxhet dhe Financa në koordinim me kryetarin e komunës dhe drejtorët e drejtorive kemi një prioritet mbulimin e obligimeve kontraktuale, pra mbulimin e shpenzimeve nga obligimet kontraktuale të kontratave të cilat janë aktive dhe financimin e plotë të projekteve të reja. Për neve qëllim kryesor mbetet konsolidimi i Komunës së Mitrovicës meqenëse tri vite radhazi jemi përballur me obligime të prapambetura me urdhra përmbartimorë si pasojë e kontratës kolektive kështu që besoj që buxheti i vitit 2025 është përpiluar në atë formë që do të ketë mbulueshmëri për të gjitha projektet kapitale, mbulueshmëri të obligimeve kontraktuale të cilat dalin nga kontratat aktive të Komunës së Mitrovicës.

Fadil Veseli: Faleminderit kryesuese. Përshëndetje Kryetar, ekzekutiv, të gjithë të pranishmit. Meqenëse jemi para një sfide, një pikë, e cila është një ndër pikat më të rëndësishme të vitit, pothuajse për shkak se në vija të trasha formohet korniza se kah duhet të shpenzohen mjetet e buxhetit të komunës. Si total nëse shikohet shuma prej 30,240,514.00 € te qytetarët tingëllon bukur një shumë e madhe kinse secili këqyr me marrë hisen e vet edhe me i ra hise që të ndikohet kryesisht në infrastrukturë dhe problemet që i kanë, mirëpo kur thjeshtohet kjo shumë dhe ndahet sipas kriterëve dhe ligjeve caktuara, atëherë bukur shumë tkurret, domethënë, krejt mundësia edhe ne si kuvendarë bie në atë se diku ka 7,200,000 € sa është totali është i paraparë për investimet dhe për shumën, të cilët qytetarët janë të interesuar t'i kryejnë obligimet, kërkesat e veta. Te kjo shumë, tash si 7 milionë, prapë tingëllon pak si kinse i bie hise shumëkujt, mirëpo siç e dimë ne, sidomos kuvendarët, dhe nëse pyeten kuvendarët secili prej nesh, minimumi i ka tri - katër kërkesa dhe të gjitha janë të arsyeshme, pa marrë parasysh pozitë dhe opozitë. Mirëpo, t'u e shikua mundësinë dhe obligimet që barten, sidomos te kontratat kornizë, që një pjesë e këtij 7 milionëshi automatikisht zbritet dhe përafërsisht diku rreth 5,000,000

me e quajtë kështu mund të jenë shuma të cilat duhet ta përfshijnë gjithë regjionin e Mitrovicës. Tash secili regjion ta quajmë Shala gjitha këto mjete me i marrë edhe besoj që nuk kanë me ju mbuluar obligimet që i kanë dhe nevojat që i kanë. Mirëpo, krejt çka mbetet tash nëse pozitë ose opozitë, cilido prej neve, kërkon një projekt që të futet këtë draft-buxhet, atëherë e krijon debalanc, dhe çka kërkohet? Kërkohet që mjetet, të cilat ai kërkon për atë investim, automatikisht duhet të zbriten për investimet që janë të parapara. Kështu që tash jemi para një dileme bukur të vështirë me vendos, po edhe para një presioni edhe të qytetarëve, për shkak se po vonohen kërkesat dhe obligimet ndaj tyre që t'ju lehtësohet sadopak jeta, por çka është pozitive për Komunën dhe për ne që në vitin e ardhshëm, Mitrovica ka përformua pozitivisht në performancë, një grant, i cili automatikisht sipas Rregullores dhe ligjit do të na takon një shumë të cilën saktësisht nuk e di, po do të jetë një shumë e mirë, për shkak të performancës pozitive të ekzekutivit. Kështu që disa projekte që ka edhe pozita, edhe opozita që kanë vlerë dhe janë më se të nevojshme, parashoh që ti ketë parasysh ekzekutivi që në vitin e ardhshëm të futen me prioritet. Faleminderit.

Fauk Mujka: Faleminderit Kryesuese. Përsëritet edhe njëherë për të gjithë. Ashtu qysh tha edhe Fadili, është ndoshta dokumenti më i rëndësishëm, i cili votohet nga Kuvendi edhe normalisht paraparakisht qysh e do rendi e qysh e dini ish vyjtë me u konsultu të gjithë hisedarët në këtë Kuvend dhe mendoj tash Kryetar që është goxha e pasinqertë edhe e pandershme me kërkua votën nga opozita për këtë buxhet. Jeni zotu dy vite rend që keni me u bë ftesë të gjithë asamblistëve me hartua së bashku buxhetin edhe ne në secilën vit po vijmë në momentin kur veç duhet me çu dorën, mendoj që kjo është tamam shpërfaqje maksimale e arrogancës së numrave. Domethënë, na i kemi numrat, na nuk kemi nevojë për juve, na e bajna, e kepin qysh dojna, vazhdojna, ju që doni e votoni, që s'doni se votoni, kush po është ngushtë? Qitu jena të gjithë, po punojmë për qytetin. Unë nuk po foli për raportin se kështu të hy në hak Kryetar, sa i përket raporteve individuale me asamblistë edhe me qytetarë, mirëpo, sa i përket trajtimit të asamblistëve, për besë, asnjë kryetar nuk i ka trajtuar në këtë mënyrë asamblistët. Domethënë, mos me i bë kështu hesap hiç as në Kuvend, as në aktivitete të tjera. Kjo është fakt e që ka dikush tjetër që e thotë ndryshe lirisht, le të urdhëron, po me këtë trend të arrogancës, Kryetar, e keni hartuar edhe buxhetin. Domethënë fare nuk keni bë diçka kreative ndonjë risi, e në qoftë se e shikon, është plagjiaturë e pastër e buxhetit të vitit të kaluar e këtë më së miri, e shihni kur e krahasoni buxhetin e vitit të kaluar, apo edhe më vonë kur e diskutojmë, kur vjen pika raporti i DSHPI-së për këtë vit, nuk ka asnjë presje, prej asaj çka kemi kërkua me procesverbal që e votuam më herët, po është një përshkrim i punëve të filluara. Po e shihni që është gati i njëjti raporti i punëve për vitin 2024 edhe projekt buxheti i vitit 2025. Buxheti është 30.2 milion € Fadil, para katër-pesë vite e kemi pas 20 milionë €, dy herë më pak ka pas për investime kapitale, por unë mendoj që ka pas dy herë e më shumë punë se me këto investime kapitale që i kemi tash. Pra, prej 30.2 milionë € 85.81% janë nga granti qeveritar ose thënë në shifra 26.6 milionë nga kjo qeveri, të cilën gjithmonë po e akuzoni se po ju lë anash, e asnjë nuk i përmendi edhe projektet e tjera financuese pos këtij granti. Tash vijmë edhe te raporti, kështu pak më i detajuar se s'po dua më marrë shumë kohë, Ende vazhdon rregullimi i objektit të komunës edhe shenjzimi i shtigjeve nëpër Shalë. E kemi një planifikim të shatërvanit në vlerë prej 50.000 € te liqeni artificial e kur s'e kena pa një projekt të tillë, por ky shatërvani te ura kryesore, kur u planifikua, sa kushtoi, kush e ndërtoi, pse e ndërtoi? Po përflitet për një çmim, nuk dua me besu që është ai çmim, po nëse është ai çmim, kjo i bie që shatërvani te liqeni do të jetë maketë e asaj që po ndërtohet te ura. E pastaj vazhdojmë me këto si me thënë seriale turke: ndërtimi i rrugëve në Kçiq, Gushavc, Vinarc, Bare, Bajgorë, gjithmonë e njëjta pa emër, pa gjatësi, e të cilat përsëriten çdo vit dhe dorën në zemër nuk është që po shihen fort realitet. Rregullimi i shtratit të lumenjëve Sitnica e Trepça, qe dy-tre vjet rend janë në projekt-buxhet, unë nuk di që ka fillu, çfarë është punu në buxhetin e kësaj. Sa i përket Ibrit, është e saktë që është punu, nuk ekziston ura, ura është heqë, si duket, ato gurë anash veç janë gjuajt, mirëpo kryesorja nuk i iket hakut që është punuar. E tash e kemi pas qe sa vjet një projekt, Strehimore për gratë e viktimate të dhunës në familje. nuk e kemi! Kur keni kërkua me qitë kulmin në shtëpinë e shurdhmecëve, keni thënë as mos u merrni me kulmin, se kemi me e ndërtua komplet shtëpinë e re të shurdhmecëve. Keni thënë u rrënuar shkolla e muzikës sepse menjëherë kemi me fillua me ndërtuar shkollën e muzikës. Pra, këto premtimet për këtë vit, janë tepricë e vitit të kaluar, e çfarë është më së interesanti, e pashë edhe në faqen tetë, ku shkruante dëgjimet buxhetore, thotë janë mbajt nëntë dëgjime e në kllapa katër, që i bie që është copy-paste e vitit të kaluar, se vitin e kaluar janë mbajt nëntë dëgjime buxhetore, por kur e kanë shkru e kanë harru me e hekë atë nëntëshin, e ka lënë nëntë, por në kllapa katër. Domethënë, i bie që është copy-paste.

Të falënderoj, kryetar! 50.000 €i ke nda për rrugën Zhazhë-Vllahi, normal, edhe kjo nga granti qeveritar, po kjo shumë nuk besoj që ndihmon shumë për ndërtimin e asaj rruge. Ndërkohë, nuk pashë zgjedhje për një premtim bashkë me këto që e pate dhënë për zgjidhjen e qirave në fshatin Qatar në Frashër. Nuk e pashë në buxhet, ndoshta është, nuk e di, nuk po dua me paragjykua për këtë punë. Është një vend ndërtimi i oborreve për 20 shkolla, për njëzet shkolla 157.00 € së paku bile “Avdullah Shabani” edhe objekti me ia filluar, po as objekti, as oborri e 157.000 €për 20 oborre të shkollave, për besë këto as dy-tre vjet e ardhshme nuk mundën me u realizuar. Mos me zgjat më shumë, ky projekt-buxhet është në një lloj në njëfarë mënyre nënçmim për asamblistët, por mendoj edhe për qytetarët sepse pak po i konsideroni si të paditur dhe pa memorie. Unë normalisht mendoj që nuk e përkrahim këtë draft, bile-bile ju rekomandoj as mos me hedhë në votim si të tillë në këtë mënyrë. Faleminderit.

Flutura Beka Kamberaj: Nëse e krahasojmë të hyrat e planifikuara për buxhetin e vitit 2023 - 2025, 2024 - 2026 dhe 2025 – 2026 dhe 2027 dhe planifikimin e të hyrave për vitin 2025 në të tri planifikimet e këtyre periudhave kemi dallime në shuma. Për shembull, planifikimi i buxhetit për vitin 2023- 2025, për vitin 2025 ka qenë i planifikuar 3,999,000.00 € planifikimi i buxhetit në vitet 2024-2026, për vitin 2025 ka qenë 3,422,000.00 €dhe ndërsa tani draft-buxheti për 2025-2026, për vitin 2025 është 3,650,000.00 € Pra, për të hyrat vetanake po flasim, planifikimi vetëm për vitin 2025, në këto tri periudha kemi ndryshim të theksuar në numra. Për vitin 2025, për dallim prej vitit 2023-2025 sa ishin të planifikuara, i kemi 600,000 €më pak ndërsa tani me planifikimin e vitit 2025 domethënë për planifikimin 2025-2027, planifikimi i të hyrave vetanake për këtë periudhë është 3,650,000.00 € apo rreth 400,000 €më pak sesa planifikimi i vitit 2023. Kjo tregon se ne kemi një buxhet jopremtues për një zhvillim të komunës dhe sigurim të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha sferat që mbulon qeverisja lokale. Bazë e përcaktimit të prioriteteve në këtë planifikim buxhetor janë kërkesat e qytetarëve të komunës sonë për të ngritur mirëqenien e tyre, mirëpo nuk janë përfshirë të gjitha kërkesat e tyre si prioritet i draft-buxhetit, siç është theksuar. Sa i përket investimeve kapitale, buxheti më tepër është i orientuar kah infrastruktura e rrugëve, ndërsa nuk ka ndonjë projekt premtues për zhvillimin ekonomik. Mendoj se së paku do të duhet të jetë përfshirë edhe rregullimi i hyrje-daljeve me katër korsi në hyrje të qytetit. Derisa komunat e vogla kanë arrit me bë qasje me katër korsi në hyrje të qytetit, ne si një prej 7 qendrave më të mëdha në Kosovë ende nuk e kemi të rregulluar. Tek projektet, investimet, QKMF-ja e re, e cila do duhet, besoj që deri në vitin e ardhshëm të jetë në funksion, janë paraparë vetëm 200,000 €për pajisje, të cilat janë të pamjaftueshme nëse projekti aktual që është një pjesë e madhe donacion, nuk përfshin inventarin edhe pajisjet e QKMF-së, shuma prej 200,000 €mendoj që është e pamjaftueshme për funksionalizim e qendrës. Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Mitrovicë janë ndarë 300,000 € nuk është cekë në cilin vend, në cilën lagje. Një problematikë tjetër e qytetit, konsideroj se është edhe qentë endacakë, kur e dimë se është një numër i madh i qenve endacakë në qytet, sa mjete janë të planifikuara për menaxhimin e qenve endacakë, cila drejtori merret me këtë çështje dhe ku i kanë planifikuar mjetet dhe a do të jenë të mjaftueshme për menaxhimin e tyre? Tek Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport mendoj se do të duhet të ndahen më shumë mjete për këtë drejtori që të sigurohemi që të kemi aktivitete më shumë kulturore, të cilat do të mund të nxisin turizmin. Tek lista e investimeve kapitale nuk figuron asnjë projekt i cili e krijon ndonjë atraksion për zhvillim të turizmit. Nuk ka asnjë projekt për avancim dhe zhvillim të infrastrukturës për zonën e lirë ekonomike. Duke pas parasysh se gjatë këtij viti komuna i ka nda disa parcela bizneseve për zhvillim të veprimtarisë, mos krijimi i kushteve infrastrukturore e bën të pamundshme zhvillimin e kësaj zone. Edhe tek Raporti i performancës, sa arrita me vërejtje janë zero pikë për shkak të mosrealizimit të aktiviteteve për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal. Nuk ka gjithashtu mjete të mjaftueshme të ndara për sipërfaqet e hapësirave së gjelbërta publike për m<sup>2</sup>, për kokë banori. Është diskutuar disa herë parku për fëmijë dhe të moshuar, e cila pronë është dhënë në shfrytëzim për parkingun e veturave përballë komunës, ndërsa pjesa e sipërme me projekt është destinuar për park. Mjetet nuk janë ndarë për rregullimin e saj edhe pse e kem diskutu këtë qe dy vite radhazi.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, shumë të respektuar anëtarë të Kuvendit, i falënderoj shumë përfaqësuesit e grupeve të kuvendarëve në kuvend, sigurisht se do të ketë edhe diskutime tjera dhe do t'i përcjell dhe do t'i dëgjoj me vëmendje shumë të madhe. Gjithmonë nevojat janë më të mëdha se mundësitë. Buxheti është ndërtua duke respektuar ligjin, edhe qarkoren buxhetore. Edhe është dashtë dhe duhet me i respektua kufijtë të cilët i kemi marrë me qarkoren e dytë buxhetore. Përndryshe, nëse buxheti aprovohet dhe procedohet jashtë kufijve të cilat i përcakton qarkorja buxhetore sigurisht se diçka e tillë nuk pranohet dhe nuk bëhet pjesë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Me e dit një trohë arrogancë që e

kam në vetvete fort kisha luftu me heqë, sepse besoj që nuk është e shëndetshme, nuk është e mirë. Po diskutimet pozitë-opozitë, secili në rolin e vet edhe i kuptoj edhe mirëkuptoj se kam pas rastin gjatë punës dhe karrierës sime me qenë në pozitë po edhe opozitë, si pozitë i kam pas diskutime tjera fare, në opozitë tjera fare. Kështu që është e kuptueshme, e mirë kuptueshme kjo farë pune, nganjëherë për të njëjtën çështje kam fol si prej pozitës, për të njëjtën prej opozitës pak më ndryshe. Ura te liqeni, është pjesë e projektit edhe është e planifikuar që të vazhdohet edhe uroj që të lidhet kontrata, të kryhet ashtu qysh është e projektuar, është pjesë e tabelave të buxhetit dhe besoj që me përfundimin e urës prapë s'përfundon ky projekt, sepse në të ardhmen kisha dashtë me pa vazhdimin e këtij projekti dhe rregullimin e shtratit të lumit deri te derdhja e Sitnicës në Ibër, ku bashkohen aty, po mundësisht ndoshta pastaj edhe ndërtim në fshatin Koshtovë. Strehimorja, objekti është përfundua dhe pritet veç me u bë përrurimi i saj dhe ju ftoj të gjithëve që të jemi bashkë në përrurimin e një objekti shumë të rëndësishëm për një kategori tepër të ndjeshme dhe tepër i nevojshëm. Shkolla e muzikës, më vjen keq, normalisht që e kam pjesën e përgjegjësise, po s'mund të dal jashtë procedurave, por përderisa unë jam Kryetar i Komunës nuk ka mundësi edhe besoj edhe në të ardhmen që ajo parcelë të përdoret për tjetër diçka, përveç për destinacionin që ka për Shkollë të muzikës, mjetet janë buxhetu edhe vitin e kaluar kanë qenë. Edhe në këtë vit janë planifikuar edhe për vitet vijuese është në procedurë, shkon në ankesa, megjithatë e dimë sa është efikase dhe sa përgjigjet në kohë OSHP-ja në lëndë, të cilat janë duke u trajtua. Rruga Zhazhë - Vllahi, është një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm, është ngritë edhe prej z. Mujka dhe të tjerëve, është tepër i rëndësishëm, i lidh dy komuna, janë ndarë disa mjete që nuk janë të mjaftueshme për me adresu këtë nevojë, se ato janë diku rreth, sa më kujtohet, në rreth katër kilometra, që do me u lidhë, mirëpo u përmend këtu, unë pres që kemi të hyra, saktë se di po milionëshe, po si rezultat i grantit të performancës dhe unë e besoj dhe shpresoj në vullnetin e asamblistëve, që një pjesë e tyre të hyrave të dedikohet për këtë projekt tepër të rëndësishëm dhe pastaj sa do të jetë participuese Komuna e Zveçanit do ta shohim; po jam i bindur që ka hapësirë me bisedu edhe me Ministri të Infrastrukturës, edhe besoj, që të na ndihmojnë përmes bashkëfinancimit për komuna. Kur jemi te kjo pjesë, çdo cent që është investu nga niveli qendror e vlerësoj. Te qiratë në Frashër te Drejtoria e Mirëqenies, te pjesa e subvencioneve, duhet të përdoren një pjesë e këtyre subvencioneve për me ia subvencionu pagesën e qirave, shiko me pas mundësi do ta trajtoj këtë çështje, nëse ka fare hapësirë, po ta diskutojmë me juristë, që Asambleja Komunale me marrë vendim, në procedurë ligjore gjithmonë po them e mira e së mirës kish me qenë qe realisht ato me i liruar prej pagesës së qirasë, na u ka thënë kur është aprovu Rregullorja që diçka e tillë është çështje e vështirë, po do ta diskutoj, përndryshe ne duhet me ua subvencionua qiratë që ata mos me i ngarkuar me qira, sepse duken shuma të vogla po për ato familje dhe për atë kategori janë më se të mjaftueshme. Zonja Beka Kamberaj, edhe një herë faleminderit shumë! Te pjesa të hyrave ne duhet t'i përmbahemi ato që na ka dhënë niveli qendror me kufijtë, mirëpo, askush s'na kufizon as Ligji, as rregulloret, që ne të mbledhim të hyra më shumë, nëse mblidhen më shumë ato neve na barten, na alokohen. Mirëpo, për qëllime të planifikimit, për shkak se logjika e kësaj na qëndron që fillimisht t'i mbledhë, dhe pastaj ti shpenzoj, për mos me krijuar obligime pa mbulesë do të thotë kanë vlerësuar që Komuna e Mitrovicës, në bazë të historikut të mbledhjes së të hyrave, këtu i ka kufijtë edhe kanë bërë një korrektim të kufijve në raport me qarkoret e kaluara, po për me grumbulluar më shumë të hyra nuk na pengon kurrkush. Të çerdhet në Mitrovicë, po flasim për këtë çerdhen, e cila është e planifikuar te ato hapësirat e ish "Desit" është në procedurë, është goxha në fazë të avancuar, presim nënshkrimin e kontratës, mjetet janë dhe unë uroj që të arrihet një diçka e tillë. E ngritët një çështje shumë të rëndësishme jo veç për Komunën e Mitrovicës, po për gjithë Kosovën, dhe nëse s'trajtohet në gjithë Kosovën ka me qenë problem veç një komunë me e adresu këtë punë, është çështja e qenve endacakë,. Kontrata duhet me u lidhë, lidhet me Drejtorinë për Emergjencja edhe paguhet prej kategorisë Mallra edhe Shërbime. Bukur kosto e madhe! Është e rregulluar qysh mundet me u trajtuar kjo punë, por në afatmesme, në afatgjatë, sigurisht se mundet me dhanë ndonjë efekt më të prekshëm, ndërsa për afatshkurtër po shihet që mënyra qysh është e rregulluar është goxha problematike, sepse njëzet e tri ditë qëndrojnë në strehimore, trajtohen, prapë duhet me u lëshu në vendin ku janë marrë në përjashtim kur konstatohet që ndonjëri prej tyre ka ndonjë sëmundje ose ka agresivitet të tepruar. Zona e lirë ekonomike, me Ministrinë e Tregtisë e Industrisë është lidhur një memorandum 1,100,00€ për investimeve apo vazhdimin e investimeve në zonën e lirë ekonomike. për rregullimin e infrastrukturës, pritet te përfundojnë procedurat, për shkak se procedurat i udhëheq Ministria e Infrastrukturës. Këto veç ishin disa sqarime në çështjet që u ngritën, po unë edhe një herë ju falënderoj shumë për diskutimet, sa i përket involvimit të anëtarëve të Asamblesë, të gjitha partitë politike i kanë anëtarët e tyre në Komitetin për Politikë e Financa dhe kemi diskutu këtë draft-buxhet, edhe sot jemi këtu për me e diskutu detajshëm. Për çështjen e votës, unë i

vlerësoj shumë diskutimet e opozitës, kur janë edhe kritike, po kur kritikant nuk janë as tendencioze, as qëllim këqija, po janë qëllim mira. Problemi është nganjëherë që kanë njerëz që ti e vëren që diçka është më se e nevojshme, po kur s'ke mundësi me financu, duhet me u kufizu. A sa i përket votës, unë pa dallim, kam obligim, me i lutë të gjithë anëtarët e Asamblesë me e votuar buxhetin, megjithatë, është në të drejtën dhe në autoritetin e secilit anëtar të Asamblesë se çfarë votë e jep, a voton për, a voton kundër apo abstenon, por unë sinqerisht i vlerësoj diskutimet, e vlerësoj kontributin edhe punë e kam me ju lutë për votë pozitive.

Vesel Neziri: E mora dhe e shikova në tërësi buxhetin, ky buxhet, po të ishte edhe 60,000,00 € nuk do t'i plotësonte kushtet për të gjitha kërkesat dhe të gjitha nevojat që ka qyteti i Mitrovicës. Ajo që më ra në sy ishte që në Komitetin për Politikë e Financa të gjitha grupet parlamentare ishin unik gjatë diskutimit të këtij buxheti, krejt çfarë kemi mundur me arrit, kanë qenë dy-tri ndryshime të vogla. Njërin prej ndryshimeve që unë e propozova, që e pashë të panevojshëm që një rrugë në Tërstenë shuma prej 30,000 € të shkon diku në një projekt tjetër që do të ishte buxhet alternativ për dikë tjetër, diku ku plotësohen kushtet, sepse edhe anëtarët e Kuvendit e dinë se në atë rrugë është investuar katër-pesë herë dhe nuk kemi nevojë të qesim zallë në breg dhe ta hedhim nëpër përrua. Në qoftë se do të kishte mundësi kjo rrugë të asfaltohet, ishte mundësia më e mirë. E falënderoj Kryetarin që nuk lejoi që ky kod të largohet dhe brenda mundësive ajo rrugë të shtrohet në asfalt. Ajo që më bëri mua me folë këtu sot ishte se, unë jam ihtar i sportit, me keqardhje dhe me admirim e kam ndjekë ndeshjen e hendbollit mes Trepçës dhe Vjosës, t'i shohësh djemtë gjashtëmbëdhjetëvjeçar duke u munduar me i mbrojt ngjyrat e klubit, të mbeten pa asnjë donacion, dhe të donatojmë në lojtarë të huaj dhe thashë shfrytëzojmë gjithë ato para dhe rinia jonë të jetë në atë gjendje, e kam ndërë veten jashtëzakonisht keq. Një trajner të reprezentacionit, një klub që ka luftu në gara ndërkombëtare të vijë në atë nivel dhe të pëson humbje prej një ekipi, po them amatoresk, e kam ndërë veten shumë përgjegjës dhe them të drejtën, vetëm për këtë e mora fjalën. I kisha lut të gjithë ata donatorë, të cilët kanë mundësi me e ndihmua dhe me nxjerrë Trepçën prej kësaj situatë çfarë është, sepse në qoftë se vazhdohet kështu, ekipi elitë do të bie nga liga. Drejtorinë Për kulturë, rini dhe sport e kisha lutë që sa më shpejt t'i kryej procedurat që të mundohemi të shpëtojmë diçka, Prandaj, kisha kërkuar që çfarëdo mundësie ta ndihmojmë këtë klub dhe ta nxjerrim nga këtë situatë që është.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Jemi të informuar për gjendjen e Klubit Hendbollistik Trepça. Çka unë po kërkoj, s'po i lus, po kërkoj që në procedurë të rregullt ligjore me i kry, me i përfundu, me bë maksimumin brenda limiteve tona Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe me i nda subvencionet për klubet sportive. Gjithashtu, po kërkoj pasi që unë po besoj që buxheti do të aprovet në kohë, ekziston mundësia e shfrytëzimit të buxheteve në një të dymbëdhjetën, me i bërë përgatitjet që subvencionet për vitin e ardhshëm me e bë thirrjen në janar. Nëse tash e bëjmë një ndarje, e bëjmë thirrjen prapë në janar dhe i bëjmë pagesat në momentin e parë kur buxheti bëhet operativ, na mundemi me iu ndihmua klubeve. Përtej kësaj, dua me besu, po e lus edhe unë, të gjitha kompanitë që operojnë në Mitrovicë, gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, që realisht me e përkrah klubin hendbollistik Trepça, na ka bë krenarë shumë herë. Ka rezultate pas veti. Po do t'i rrimë mbrapa brenda kapaciteteve tona financiare që klubi të jetë i përkrahur. Kështu që faleminderit shumë që e ngrite si temë, edhe besoj që në këtë pikë të gjithë jemi të barabartë, pa dallim, dhe jam i bindur që secili anëtar i asamblesë dëshiron që Komuna e Mitrovicës, brenda kapaciteteve e limiteve të veta financiare, ta bëjë maksimumin.

Florina Çitaku: Sot kemi para vetes projekt buxhetin e fundit që do të jetë operacional për këtë mandat qeverisës edhe planifikimi i të cilit shpërfaq shumë mirë realizimin e premtimeve qenësore të Kryetarit zotëri Hamza. Këtë e them duke e parë që janë drejt finalizimit projektet madhore, si Rrugët "Ali Zeneli" dhe "Lah Nimani", për çka i uroj të gjithë qytetarët e Mitrovicës, të gjithë juve dhe ju ekzekutivë të nderuar, ju përgëzoj për këtë arritur të madhe! Mitrovica, kolegë të nderuar, për herë të parë u bë me objekt të Bibliotekës së Qytetit, që për mendimin tim është një arritur historike e kjo se qyteti nuk ka pasur asnjëherë objekt për Bibliotekën e Qytetit edhe kjo e arritur i atribuohet komplet kësaj qeverisje, Ballkoni Panoramik, pastaj investimet te liqeni artificial, janë edhe këto hapa konkretë, të cilët veçse po ndikojnë në rritjen e interesimit për turizëm në qytetin tonë. Gjithashtu, edhe investimet në fushën e arsimit dhe në fushën e shëndetësisë, që kanë qenë premtime qenësore të kësaj qeverisje veçse janë në finalizim e sipër shumica prej tyre. Infrastruktura nëpër shkolla dhe në objektet shëndetësore janë disa të arritura që nuk mund të anashkalohen, pavarësisht që kjo ndoshta dikujt edhe mund të mos i pëlqej. Infrastruktura unë e kuptoj që nuk është indikator kryesor që mund të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve as të mësimdhënies, që është te fusha e arsimit, po as te ngritja e shërbimeve ose ngritja e mirëqenies tek qytetarët, mirëpo është indikator qenësor, është indikator kryesor që ndikon në ngritjen ose



në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve dhe këtu edhe projekte të tjera, të cilat për shkak të kohës nuk po i përmend, kanë bërë që neve si Komunë të arrijmë në pozicionin ku i prijme listës së komunave me realizim me premtime më së shumti të realizuara. Në emrin tim, këtë çfarë po e them, nuk po e them se po e them unë, mirëpo po bazohem në të dhënat zyrtare, në të dhënat të Instituteve të ndryshme, të cilat merren me statistika të tilla, mund ta përmendi institutin GAP ose ndonjë tjetër, edhe do të thotë në të dhënat e tyre po bazohem. Dhe kështu, në emrin tim personal dhe në emër të qytetarëve të Mitrovicës, jam falënderuese për zotëriun Hamza, për Kryetarin tonë, gjithashtu për gjithë ekzekutivin e tij që ka lënë gjurmë ekonomike dhe historike në qytetin tonë për përgjatë këtij mandati qeverisës dhe kam bindje të plotë që deri në përfundim të këtij mandati do të realizohen edhe ato pak premtime që janë që janë në realizim e sipër dhe kështu edhe ju përgëzoj Kryetar për qasjen tuaj shumë profesionale, shumë pozitive dhe shumë edukative ndaj neve të gjithëve si asamblistë, po edhe ndaj çdo qytetari të Mitrovicës.

Ekrem Sadiku: Në qoftë se kishte mundur me u cilësua si një Kryetar i cili ka lënë gjurmë historike, ish dashtë me argumentua edhe projekte tjera e jo vetëm një Park Panoramik ose një Bibliotekë, ish dashtë me i parapri diskutimit, por besoj që kish dalë ma mirë. I nderuar Kryetar, absolutisht pajtohem me parafolësit se si dokument draft-buxheti është mjaft i rëndësishëm për komunën e Mitrovicës dhe njëkohësisht pajtoem që absolutisht nuk keni arrogancë verbale në raport me asnjë prej neve, mirëpo nuk kualifikohet arroganca vetëm në kuptimin verbal, sa i përket arrogancës politike, unë mundem me ju argumentu, sepse kjo ka ekzistuar që nga ardhja juaj dhe këtë tash po ua listoj, juve dhe secilit këtu, meqë kemi qenë dëshmitarë, që nga 2023, ju në vazhdimësi sa ka ardhë draft-buxheti, pa ndonjë presion, ju keni deklaruar se buxhetin do ta bëjmë bashkërisht, gjë për të cilën unë në njëfarë forme të kam duartrokatur këtu. KPF-ja ka ekzistuar dhe atëherë, Kryetar, dhe është mbajtur mbledhje, sepse është mbledhje para seancës, mirëpo diskutimi ka qenë dhe premtimi juaj ka qenë që ne bashkë ta bëjmë buxhetin dhe t'i shohim edhe kërkesat tona. Argument tjetër është se na, secili prej neve i marrim votat prej disa lokacioneve, disa fshatrave, një pjesë të qytetit pak më shumë dhe natyrisht edhe borxhet dhe kërkesat i marrim edhe prej aty, sepse ne jemi përfaqësuesit e atyre votuesve. Ajo çka unë muna personalisht me ju thanë, asnjë kërkesë prej që jam asamblist, të cilin e kam paraqitë këtu, kërkesa joindividuale, mirëpo të votuesve tanë, nuk është realizu dhe, këto kërkesa kryetarët e fshatrave dhe të lokaliteteve i kanë prur edhe të protokolluara, të shkruara sidomos në DSHPI. asnjë s'është realizu. Ndërsa sa i përket buxhetit, Kryetar, edhe ju të pranishëm, unë e shoh këtë si një përsëritje, pjesa dërrmuese e pikave do të thotë, janë projekte të përsëritura dhe unë mundem vetëm disa me t'i specifikuar. Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica, e ki në 2023, asfaltimi i rrugëve, shiko këtu: Vllahi, Melenicë, Bajgorë, Stantërg, 2 Korrik, Shupkocv, Vinarc, tash vetëm janë shtuar në këtë rubrikë edhe Bairi, Ilirida dhe Qendra, 2023, krejt tri vite radhazi i keni në buxhet, asnjë s'është kryer. A s'është kjo arrogancë në kuptimin politik? Shkolla e muzikës, vazhdimisht, pse s'e keni largu, vazhdimisht ka qenë projekt, rruga në Vinarc, Gushavc, ndërtimi i rrugëve në Vaganicë është vazhdimisht. Unë shpesh po akuzohem që jam goxha lokalist, mirëpo nuk kam qare pa i potencuar, sepse jam përfaqësues i votuesve dhe i qytetarëve të Komunës së Mitrovicës dhe këtë dua me e theksuar edhe një herë, ua kam theksuar edhe vitin e kaluar. Kryetar, afërsisht njëzet e katër fshatra këtu i keni që nuk keni bërë asnjë investim, zero investime dhe ajo çfarë është më e keqja, prapë nuk janë të përfshira në buxhet, ky është diskriminim sepse buxheti komunal kish qenë dashtë me qenë më gjithëpërfshirës. Unë për hir të korrektësisë dhe për hir të qytetarëve, kam me i listua krejt, sepse edhe atëherë t'i kam listuar. Po, kaq janë dalë, Kaçandoll zero investime, Bare zero investime. Këtu dua me qenë korrekt, sepse QKMF-të janë, ambulancat janë renovuar, që është cikël i përhershëm dhe duhet me u mirëmbajtë ato, Kovaçicë zero investime, Vidishiq zero investime, Selac zero investime, Melenicë zero investime, edhe pse i keni paraparë. Domethënë, prej 2023 nuk keni investime, Maxherë zero investime, Vllahi zero investime, Stantërg zero investime, Edhe në Vllahi kanë qenë të parapara, mirëpo nuk kanë përfunduar rrugët i nderuar, e di që keni intervenu në atë rrugën, e ka fillu dhe përfunduar prej 2023 dallimi i madh, Stantërg zero investime, Rahovë zero investime, Lisicë zero investime, Zasellë zero investime, Kutllovc zero investime, Gushavc një rrugë zero investime, Vidimriq zero investime, edhe Kollovërdë sepse janë do premtime të cilat nuk janë krye asnjëherë. Tani, Kryetar, a s'është kjo një lloj arrogance politike, përderisa çdo kërkesë unë e kam potencua vazhdimisht këtu, a kish qenë dashtë Kryetar që ne me pas një bashkë koordinim para se me ardh draft-buxheti këtu në mënyrë që edhe na të kemi një lloj interesi dhe një lloj motivimi, pa dashtë me i minimizua rëndësinë e projekteve të cilat i keni paraqitë këtu, mirëpo, kish dashtë me qenë dhe do të thotë me ardh në shprehje edhe kërkesat e atyre votuesve tanë, sepse nuk jam këtu për kërkesa personale.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Nuk ka pikë lidhje arroganca me këto që po e thua, jo nuk ka kurrë as politike as personale. Po situata është kjo, nevojat e Komunës së Mitrovicës janë më të mëdha se mundësitë për financim, brenda këtyre mundësive ne duhet me i zgjedh prioritetet. Unë nuk e besoj që as pas dy mandateve, as pas tri, as pas pesë mandateve ka me ardh situata që në këtë asamble me thënë janë kryer punët e s'po dimë çka me bë, po na teprojnë paret. Por ne duhet të kryejmë punë aq sa kemi mjete financiare. Kam qenë tepër i kujdesshëm edhe insistues, edhe sot po e them, që na të buxhetojmë projekte aq sa kemi mundësi për financim. Mos të prodhohet situata ku ne lidhim kontrata dhe nuk kemi mundësi për t'i paguar. Kemi qenë të penalizuar që kemi paguar më shumë se 10,000,000 € obligime të prapambetura pa ia referu që ka qenë komplet pjesë e përgjegjësisë së nivelit lokal por ne kemi paguar, janë shumë për Komunën e Mitrovicës, unë jam këtu për të treguar çka kemi punuar. Ne kemi folë për Rrugën “Mbretëresha Teutë”, na kemi folë për rregullimin e Qendrave të Mjekësisë Familjare, ambulanta e Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, na kemi folë për Rrugën “Ali Zeneli”, na kemi folë për Rrugën “Lah Nimani”, na kemi folë për shtratin e lumit Ibër, na kemi folë për rregullimin e shkollave, për subvencione dhe unë kam dalë me një program në fushatë zgjedhore. Sot, kurdo që të maten indikatorë, del që për dy vjet e gjysmë diku më shumë se 70% e premtimeve janë të përmbushura, 20% janë gjysmë të përmbushura apo të filluara dhe 10% janë që ende s'kanë filluar. Kisha me qenë shumë i lumtur këtu bashkë me juve me thanë që po kemi mundësi financiare me financuar shumë projekte të tjera. Janë edhe një shumë që Komuna e Mitrovicës ka me përfutur si rezultat i grantit të performancës, sa është shuma nuk e di. Jam i gatshëm me i ndëgju kërkesat dhe kërkesat brenda asaj shume me i akomodu por nuk mund me e akomodu edhe rrugën Zhazhë-Vllahi edhe projekte tjera se nuk është që mundesh me siguru financimin. Financimet edhe projektet janë shpërndarë në të gjitha anët e komunës të Mitrovicës sipas prioriteteve që ekzistojnë. Në Eqrem Çabej mësojnë fëmijët e qytetarëve të Mitrovicës, Skënderbeu, njëjtë, kudo qoftë. Prandaj, kisha me qenë shumë i lumtur me pasë më shumë para. Dëgjimet buxhetore i kemi mbajt. Kryetarët e fshatrave kanë ardhë me kërkesa, i kam taku, i kam dëgju, nuk ka mundësi brenda një mandati me i përfshijë të gjithë. Po, edhe në Vinarc jemi prezent me punë, edhe në Gushavc jemi prezent me punë, gjithandej jemi prezent me punë edhe në Vaganicë. Pres që me qenë edhe në vende tjera, kështu që kjo qeverisje, ky mandat i adreson disa punë, disa projekte po jo të gjitha, tjerat mbesin mandatet vijuese. Kisha me qenë sikur edhe ti i lumtur me pas mundësi me thonë çka do, çdo kërkesë e qytetarëve çdo nevojë, çdo kërkesë të një asamblisti ose asamblisteje mundem me akomodu brenda mundësive për financim, ne i kemi kufijtë. Kështu që edhe një herë faleminderit shumë, të kuptoj, të mirëkuptoj shumë drejtë. E the gjithkush e ka dikë ku i merr votat, a i merr në një Fshat, a i merr në një Lagje, ai i merr në një lokalitet edhe normalisht që do me krye punën e vet edhe me qenë korrekt me ata që e kanë votuar, këtu s'kemi asnjë dallim, dallimi është që na financojmë projekte aq sa kemi mundësi, përtej saj nuk mundëm, qejf kemi, nevojat kemi.

Ekrem Sadiku: Kryetar, sa i përket procedurave të planifikimit të realizimit, absolutisht pajtohem sepse duhet me pas bazën ligjore, paret edhe realizimin, këtu pajtohem, unë jam duke i shpreh kërkesat e qytetarëve të Komunës së Mitrovicës dhe këto t'i argumentova një nga një, vetëm i mbeta borxh edhe këtij kolegut se tha i numërova vetëm pak. Po ia numëroj edhe ato të tjerat, është Cërnusha, është Dedia, është Batahiri, është Ofçari, është Tuneli i Parë. Janë kërkesat e qytetarëve të cilët unë i përfaqësoj këtu.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Kur flasim edhe i përmendëm fshatrat, duhet me i specifiku a po flasim për rrugë, a po flasim për shkolla a po flasim për çerdhe, a po flasim për ambulanca, për çfarë po flasim?! Prandaj, nuk kam mundur me i lanë 600 - 700 familje në Rrugën “Ali Zeneli” pa u trajtu, në gjendjen ekzistuese në krahasim me kudo qoftë në një vend që edhe një shtëpi në qoftë edhe një familje në qoftë duhet me e trajtu me një vend që ndoshta numri banor është ma i vogël. Kaq janë kapacitetet tona financiare, nevojat janë shumë më shumë.

Xhevrije Bhatiri Ademi: Zoti Kryetar, më ke dhënë një premtim, që nuk është mbajt, nuk pe dimë arsyen. Ke thënë që viti i ri shkollor do të fillojë në Gjimnaz të renovuar me sallë të edukatës fizike të re. Zoti Kryetar, kaloi një vit, një vendim i Kuvendit nuk është plotësuar dua të di për sallën e edukatës fizike tek shkolla në Gurshavc, duhet të dijë për urën tek Liqeni, së paku pse s'ka përfunduar bile udhëtarët, këmbësorët që kalojnë andej ose këndej sidomos për të moshuarit po është pak më problem. Unë fola paraprakisht edhe me drejtorin për Rini, Kulturë e Sport, fillimi i vitit të ri shkollor ka fillu gati që një muaj, një top e kam në sallë që mundohemi me mbajt orën e edukatës fizike, kur kemi rast tri paralele jemi brenda sallës. Jo vetëm në gjimnaz sepse jam në bordin e Shoqatës së Pedagoqeve të Kosovës, po të gjitha shkollat që janë, tek sallat e profesorëve të edukatës fizike mungojnë rekuizitat. Zvarritja është shumë e madhe. Nuk mundesh t'i me mbajt orën e

edukatës fizike me 60 veta në klasë me një top, na mundem me mbajt njëzet minuta aktivitet fizik, pra jo diçka tjetër. Unë e falënderoj nënkryetarin, kur kemi qenë pjesëmarrës në garën në nivel shtetëror, nuk kam pasur me çka ti çoi nxënësit në garë edhe pse ishim fituesi i saj. Ju kam drejtuar nënkryetarin, na ka qitë shpejt e shpejt 200 € veç me marrë pjesë në atë garë. Ne të gjithë jemi prindër këtu, 90% jemi prindër dhe secili kemi fëmijë. Të gjithë e dimë nivelin e aktivitetit të rinisë sot çfarë e ka. Kisha pas dëshirë dikush nga ju veç me ardh me e pa, çfarë gjendje e kemi rininë, beso shpirti po më dhemb, se qysh e kam një klasë, janë tmerr, s'kanë aktivitet. Beso që me shpirt po punojmë edhe na duhet ndihma e juve se vërtet është keq. Unë, edhe me drejtorin e shkollës kam bisedua, por janë procedura që duhet të priten gati një gjysmë viti shkollor, ato po mungojnë. Sa i përket klubit hendbollistik, vërtet është për keqardhje, jo që po koritet klubi, por koritet një qytet. Kështu që duhet të investojmë në aktivitet fizik.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Faleminderit zonja Bahtiri Ademi! Shumë korrekt prej anës tënde. Kisha pas ma lehtë me thanë s'po pajtohem. Çështjet që i ngrite, shumë po pajtohem, po bëj përpjekje me i dhënë disa sqarime. Te çështja e gjimnazit situata është përafërsisht e njëjtë si te shkolla e muzikës. Unë e di që ju i keni votuar dhe i keni nda mjetet për rinovimin e Gjimnazit, qe dy vite, ka qenë edhe vitin e kaluar pjesë e tabelave të buxhetit, është edhe këtë vit, në procedurë ka qenë, ankesa është e drejtë ligjore, nuk mundem me thënë pse po ankohen njerëzit, por është e drejtë e garantuar ligjore dhe kushtetuese, po vonesa në shqyrtimin e ankesave po ka jashtëzakonisht shumë. Unë po dua me besua që ka me u lidhë kontrata. se qysh është gjendja i kam pas fëmijët në atë shkollë, e di, e dini edhe ju që punoni aty. Përtej kësaj edhe më e rëndë është kur dëgjoj që shkolla përballet me disa mungesa që fare s'duhet me u diskutua. Unë po i besoj që janë mungesat, po mungesat janë përgjegjësi menaxheriale, duke fillua prej drejtorit të shkollës e deri te unë, nuk është Komuna e Mitrovicës në situatë kur nuk mundet me u bë furnizime të mjaftueshme me elemente të caktuara, kjo është puro neglizhencë e faktorit njeri, fare nuk pe amnistoj veten prej përgjegjësisë, krejt ata bartës le të ulen e te marrin mesazhin e qartë që nuk janë në rregull. E kur s'janë në rregull duhet me pas edhe veprime. Te ura e liqenit, nëse po i referohesh asaj lart atje, është duke u punuar, është në fazën finale dhe po pres që ndoshta, nuk po jap afate, por po dua me besu që brenda muajit tetor me u përfunduar si projekt, gjithmonë ka hapësirë për përmirësim. Diskutoam deri tash disproporcionin mes nevojave dhe mundësive, tash ramë në një rrafsh tjetër po diskutojmë për një diçka çka s'duhet me ndodhë, çka s'duhet me ndodhë edhe te klubi hendbollistik. Mirë që janë drejtuar këtu dhe po kërkoj gjithmonë t'u respektu të gjitha hapat ligjorë që klubet sportive me i marrë mjetet të cilat i ka aprovu ky Kuvend këtë vit dhe për vitin e ardhshëm pasi që ka mundësi që shuma me qenë më e madhe për subvencionim mos me i pritë tetorin dhe nëntorin po le të bëjnë shpalljen në janar, s'po di qysh me qenë më i qartë! Në janar bëje shpalljen! Le të aplikojnë klubet për me i marrë subvencionet, të cilat ia dedikon dhe ia ndanë ky Kuvend.

Xhyljeta Imeri: Jam e lumtur që kërkesa ime në Komitetin për Politikë dhe Financa është aprovuar për subvencionimin e Drejtorisë së Arsimit ku janë ndarë mjetet prej 50,000.00 € Nga kjo shumë 30,000.00 € do të shfrytëzohen për bursa në SHMLT "Arkitekt Sinani", ndërsa 20,000.00 € janë të dedikuara veçanërisht për mbështetjen e nxënësve që arrijnë rezultate të shkëlqyera në gara. Ky hap është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të inkurajuar dhe motivuar të rinjtë tanë të zhvillojnë talentet dhe aftësitë e tyre. Mbështetja për arsimin është investim për të ardhmen e fëmijëve tanë dhe shoqërisë sonë. Për Drejtorinë e Arsimit po e përsëris kërkesën që të hapen konkurse për psikologë në shkolla duke theksuar rëndësinë e tyre për mirëqenien dhe zhvillimin emocional të nxënësve. Tek pagat e planifikuara për pozitat e paplotësuara e keni mundësinë t'i planifikoni edhe këto. Po ashtu kërkoj të hapet klasa para fillore në SHFMU "Aziz Sylejmani" në Mitrovicë, e që aktualisht mungon, me ligjin për edukimin në fëmijërinë e hershme edukimi para fillor është i obligueshëm. Drejtoreshë, planifikimi është në dorën tuaj. Tri çerdhet e planifikuara uroj që sa me parë të fillojnë punimet e mos të kenë fatin e Çerdhes në Shipol. Krijimi i këtyre çerdheve jo vetëm që ndihmon në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve, por gjithashtu ul nivelin e papunësisë së grave, duke u mundësuar atyre të angazhohen në tregun e punës. Për më tepër, prindërit përfitojnë nga kjo kosto më e ulët e kujdesit për fëmijët. Pikë tjetër janë edhe kabinetet shkollore të cilat duhet të ndahen proporcionalisht edhe në shkolla fillore, jo vetëm në ato të mesme. Diçka që më bëri përshtypje dhe dua një shpjegim tek të hyrat vetanake dhe tek Drejtoria e Arsimit është një shënim ku shkruan çerdhja në Shipol nëse arrihen të hyrat vetanake do të ndahen për të. E çka nëse nuk ë realizohen të hyrat vetanake? Për mua është e pakuptimtë. Do të thotë ndalet funksionalizimi i saj apo çka do të jetë. Gjithashtu në mesin e shumë rrugëve te planifikuara për rregullimin e tyre ishin disa fshatra të cilat nuk kanë qenë më parë, ku edhe kërkesë e imja ka qenë qe të investohet në

infrastrukturën e fshatrave, të iu lehtësohet jeta banorëve sado i vogël të jetë numri i tyre. Tek Kodi “Ndërtimi i rrugëve në lagjen “Ilirida” kërkoj të bëhet rregullimi i rrugës “Agim Ramadani” tek ish ambulanta Nëna Terezë dhe Rruga “Çamëria”. Do të filloja të komentoj buxhetin nga planifikimi i të hyrave edhe pse nuk kam shumë komente ngase ato janë të bëra pothuajse njësoj nga viti në vit me ca ndryshime kozmetike. Ajo që më bie në sy është se ne planifikojmë të mbledhim të hyra nga personat që jetojnë me ndihma sociale, vërtetimi që merr ndihmë sociale duhet lëshuar pa pagesë për këtë kategori sepse për buxhetin e Komunës 200 € nuk janë asgjë, e për familjet në nevojë edhe 1 cent është i vlefshëm, meqenëse numri i tyre është më i madh, nuk besoj që do t’i kemi vetëm 200 familje me asistencë sociale. Nuk po kërkoj të largohet si kategori buxhetore, por po e ripërsëris të merret si vendim që të lirohet kjo kategori. Gjithashtu kërkoj nga ju që projektet që do të marrin miratimin sot, të fillojnë nga sot përgatitja e tyre që për muajin Janar të jenë te gatshme, mos të kemi zvarritje me përshkrimin e projekteve, tenderëve sikurse ka ndodhur me oborrin e Shkollës “Abdullah Shabani”, çerdhja, klasa aneks në shkollën “Aziz Sylejmani” e që të gjitha është dashur të jenë të përfunduara në muajin Gusht e shumë projekte tjera.

Armend Begu: Gjatë këtij mandati, unë kam bërë shumë kërkesa, kërkesat e mia kanë qenë gjithmonë të bazuara në kërkesa që kanë qenë me prioritet, mirëpo deri më tani, tri vjet kaluan, asnjë kërkesë që i kam shtrur këtu për qytetarët, se ne jemi duke i përfaqësua ata, nuk është realizuar. Kështu që për fillim po ju kallëzoj, vota jeme për buxhet shkon kundër, jo kundër po nuk votoj fare, për shkak se krejt këto kërkesa që i kam bërë që tri vite janë vetëm duhet t’i përsëritë nëpër listat në buxhet, në draft buxhet, ndërsa nuk realizohen. Për shembull, në fshatin Vllahi është një rrugicë që akoma janë banorët aty, është jetike për m’i ndalë banorët për me mbet aty dhe nuk shtrohet, nuk rregullohet. Tjetra, është premtua, vetë Kryetari ka thënë që e kam nda një fond prej 50,000 € për ujësjellësin e Fshatit Vllahi dhe Zjaçë, Melenica veç ka hyrë nëpër lista, po kurrë nuk u realizu asnjëherë. Asnjëherë nuk kam dashtë edhe pse jemi kundërshtar politik, në nivelin lokal nuk kam dashtë me kanë vetëm si opozitë jo konstruktive që na me adresu problemet e qytetarëve që i rëndojnë për çdo ditë dhe që janë të shumta. Për shembull, në Rrugën “Rifat Dedija” e kam bërë një kërkesë ku ka pacienta me dializë dhe ata dy-tre pacienta, të cilët duhet me ecë kanë 150 metra për me dalë te ambulanca edhe kjo unë nuk e di që është realizu edhe ka marrë përsipër drejtori, me sa di kryetari i ka thënë këtu në prezencë të drejtorit merru me këtë çështje, nuk e di a është realizu, në atë rrugicë, krejt janë familje të ish-luftëtarëve të UÇK-së dhe veteranë të luftës, ne po ndërtojmë përmendore të luftës së UÇK-së a s’po i trajtojmë këta të gjallë që kanë qenë pjesëmarrës në luftë. Tjetër, një çështje që e kam shtruar këtu ka qenë edhe çështja e qenëve endacakë, kam marrë vesh që ekziston një qendër strehimore në fshatin Lushtë, po qenka me kapacitete të limituara, kush e ka financua, kush e financon unë se di atë, a e financon komuna, a e financon ministria? Për shembull dje kam qenë i ftuar në një event në fshatin Selac që është rregullu një shteg i ecjes, unë jam shumë admirues dhe jam frekuentues i këtyre gjërave, mirëpo në fshatin Selac asnjë investim nuk u bë në rrugicat e atyre banorëve aty, a po iu ndërtohet një shteg i ecjes, i cili nuk është për ta. Ky shteg i ecjes është për qytetarët e Mitrovicës, që duan me shkua me frekuentua atje me ecë besoj që pajtoheni se ata vetë nuk kanë me ecë, deri në majën e mprehtë atje. Mandej është problemi i OMNI sportit, që dy vite kanë ndodhë dëmet aty e nuk ka realizim të punimeve, nuk ka kryerje, nuk është lëshua, nuk është rregullu, thjesht qytetarët nuk kanë qasje. Në fshatin Frashër nuk janë vetëm qiratë, janë edhe rrethojat që janë aty, banorët po ankohen që edhe rrethojat nuk janë rregullua edhe po kanë probleme. Tjetër, për ndriçim nuk po flasim. Unë mendoj, Kryetar, që nuk është bërë ndarje proporcionale e prioritetëve, jo e mjeteve, po e prioritetëve Për shembull, është dashtë nga pak me investua në të gjitha, me i prekë ka pak çdo lokalitet që me e ndier edhe ata dorën e pushtetit ose ndihmën e pushtetit. S’ka ndriçim nëpër fshatra, në Vllahi në fshatin tim nuk ka ndriçim. Në krejt fshatrat e Shalës nuk është bërë asnjë investim, ndriçim nuk ka, vetëm deri në Tunel në Stantërg, më tutje s’ka. Nuk ka ujësjellës, është problemi ma jetik uji, nuk u realizua asnjë projekt për ujësjellës. Unë po e kuptoj këtë dhe mos me hy tash në qytet, rrugët që kanë fillu pa afate kohore, unë e di që nuk kryhen brenda natës edhe brenda muajit nuk mund të kryhen, ajo kuptohet, mirëpo Rruga “Katana - Agim Ramadani”, që dhjetë muaj e më tepër ka fillu qytetarët janë mërzitë nga pluhuri, nga zhurma. Plus punimet, unë kam edhe fotografi që kam bërë vetë, veç linjat e tensionit të lartë, që është dashtë me qenë një metër e gjysmë thellë, janë tridhjetë centimetra. Aty ka me qenë rrezik permanent për ata që nesër dikush që donë me bërë një gërryerje vetë-vetiu, pa planifikim, edhe e çon bagerin aty është rrezik për me shkaktë katastrofë. Nuk e di, pranimi kur bëhet, nëse bëhet pranimi, atëherë në rregull, ata që merren me këto punë, ata kanë tregu që duhet me kanë një metër e gjysmë, 30 cm zall ajo shtresa ku paralajmëron prapë zall se është tensioni i lartë, aty është 30 cm tensioni i lartë. Kjo

vërtetohet kur doni ju, nëse doni ua qes me fotografi. Këto janë ato ma kryesoret unë s'po hi në shifra. Në Rugën "Ali Zeneli" ka shpërthyer një gyp i ujërave të zeza, cila kompani ka punu atje nuk e di, mirëpo aty me javë është qashtu gjendja e njëjtë. Nuk e di a është kry, nëse u kry në rregull është.

Gjergj Beka: Sa i përket buxhetit, uroj veç të zbatohet në praktikë dhe të realizohet. Kam një kërkesë që të jetë pjesë e këtij buxheti një propozim që në udhëkryqin Tavnik, Rugën "Nëna Terezë", të vendosen disa semaforë pasi që jemi dëshmitarë që kohëve të fundit është ndër udhëkryqet që më së shumti ka aksidente. Gjithashtu, po besoj ditëve të fundit iu ka ardh një kërkesë nga Këshilli i Fshatit i nderuar, Kryetar po besoj që ta keni parasysh dhe të realizoni këto kërkesa.

Kushtrim Zeneli: Ky draft-buxhet për vitin 2025 dhe vlerësimet për 2026 - 2027, kur po i shikoj disa kërkesa që i kemi bërë, më shumë po e shpërfaq mos punën ndoshta, nëse s'mundemi me i thënë arrogancë, ky draft-buxhet po del të jetë goxha diskriminues. Fillimisht, Kryetar, po të tregoj që po të jam shumë i shkurtër. Unë po i përmendi vetëm katër problematika të cilët po e prekin direkt jetën e qytetarëve dhe pas çdo projekti po e bëj pyetjen: pse? Është problemi ujësjellësit të fshatrave Rashan, Tërstenë, Mazhiq, Trepçali. për çdo vit i kemi nda nga 50,000 € dhe 100,000 € edhe ende, kjo çështje nuk është rregullu. Ka pas banorë të organizuar të këtyre fshatrave, të cilët kanë ardh kanë kërkuar takim tek ti, tek nënkryetari, tek drejtori, prapë kjo çështje nuk është rregullu. Prapë edhe në këtë draft-buxhet për vitin 2026-2027 parashihet ndodhet një shumë për rregullimin e këtyre pompave po kjo shumë pak e pabesueshme edhe kur dihet se tash kemi orën në një pikë tjetër. Kjo po e rëndon jetën e qytetarëve. Po folmi për ujin esencial të pijes, kur buxheti parashihet të jetë mbi tridhjetë milionë € Pse Kryetar s'po rregullohet kjo çështje? E dyta, po e potencoj rregullimin e mburojave të Rugës Trepçë – Rashan - Mazhiq, edhe nëpër zona tjera, Melenicë, Vllahi e tjera. Sidomos gjatë stinës së dimrit po paraqiten shumë rreziqe gjatë frekuentimit të rrugës. Vetëm rrugën për Rashan e frekuentojnë mbi dyqind vetura gjatë ditës dhe prapë se prapë kjo e pa mburojë, edhe pse e kemi ngritë këtë çështje më herët. Çështja e tretë Kryetar është ndriçimi publik. Në Frashër janë mbi 50 familje edhe ende s'ka ndriçim publik, s'ka ndriçim publik në Rashan, s'ka ndriçim publik qysh e përmendi edhe Armendi dhe disa pjesë tjera. Pse kryetar nuk po realizohet kjo? Është kërkesë esenciale. E katërta dhe që po e përmbylli, kanë qenë funksionale zyrat e gjendjes civile në Trepçë dhe Bare. Kemi kërkuar nëse s'munden me u funksionalizuar këto zyra të gjendjes civile me u rivendos E-kioskat. Nuk është në rregull një qytetar prej Bajgore me ardh me nxjerrë certifikatë të lindjes në Mitrovicë, nuk është në rregull një banor i fshatit Rashan me ardh me nxjerrë një certifikatë në Mitrovicë. Kemi kërkuar meq këto zyra kanë qenë funksionale, tash janë defunksionale, por veç sa i kemi kërku E-kioskat, kemi kërkuar edhe vendosjen e kioskave në Trepçë edhe Bare, domethënë propozimet edhe votimet mbahen për me lehtësua jetën qytetarëve e kjo më shumë po e rëndon. Për përmbyllje janë edhe disa çështje tjera, por po i lë për të më vonë edhe raportet tjera, por me kaq për përmbyllje.

Sevdaim Uka: Po mundohem të jem sa më i shkurtër, Kryetar, ti më herët e ceke, që diku kanë qenë rreth njëqind zotime, 70% janë arrit, 20% prej tyre janë dalë në punë gjysmë të kryera, 10% janë që ende s'kanë fillu. Ndoshta po e marr pak kohën, unë po më lejoni vetëm të kthehem pak në kohë të buxheti 2023, një video është shumë e shkurtër. (Dëgjohet video incizimi) *"Unë zotri Uka! Përshëndetje për të gjithë! Iu drejtohem kryetarit për një pyetje, për një çështje të kahmotshme, veç për çështje të kureshtjes sa është vendosja e numrave postarë në Komunën e Mitrovicës, se vërtetë është çështje elementare, gjithëpërfshirëse për të gjithë, po shkojta në përfundimin e vitit dy 2023 dhe një kontratë sa më të thjeshtë me e bë, kur po është çështja me vendos numrin postar po ngushtohet njeri se s'po ke hapësirë, komunat tjera e kanë përfundu, kemi mbetë veç ne, a duhet afat i gjatë kohor, kur shihet një afat që mundet me përfundu, a është shumë kosto e lartë, pak a shumë një sqarim, veç çështje kureshtje! Faleminderit, paraprakisht kryetar! Kryetari i Komunës z.Bedri Hamza: Faleminderit, zoti Uka! Faleminderit shumë për pyetje! Dhe që disa herë me shumë të drejtë e ngritë këtë çështje shumë të rëndësishme për qytetarët e Mitrovicës, çka unë marr zotim që koston kam me gjetë mënyra qysh me akomodua në buxhet të vitit të ardhshëm që sigurisht se do të kemi një bartje të dhe prej tyre ne mundemi me vendosë projekte të reja. Ndërsa komplet procedurat edhe dizajnimin e projektit, unë besoj që drejtoritë përkatëse do t'i drejtoj me u ulë me juve, pasi që veç keni edhe... (ndërpritet videoja).*

Sevdaim Uka: Më fal, ndoshta e mora pak kohë, po deshta veç me kthy pak kohën, pasi që janë edhe mediat, është e nevojshme, kryetar do të thotë komunat fqinje veç e kanë kry, Skënderaji, Vushtrria. Një pjesë tjetër, se s'desha me ju lodhë me video, por pasi jemi në kohën e teknologjisë, kërkoj edhe një herë ndjesë nëse ka pengua, ka qenë edhe diskutimi për një urë improvizuese për bujqit në Shupkocv, Kçiq i Vogël që e kemi diskutu që do të investohet një urë më e modernizume, këtu te qasja te Luxi ku kalojnë ambulancat, ku është e

mundshme me kalu vetëm një veturë po unë po ju shoh qysh është gjendja e buxhetit, s'po mundem me qenë i tepërt. Kish qenë shumë e mirë edhe kjo, nëse kish qenë e arritshme mirëpo na po duhet me vepru në bazë të mundësive që kemi. Ndërsa sa i përket do të thotë njëqind zotimeve, edhe një ta rikujtova, shpresoj që do mbahet, është gjithë përfshirë se nuk është lokaliste dhe na ndihmon të gjithëve, se një ndihmë, shpesh me i thirr policinë, me i thirr për raste emergjente, nuk mundesh me i orientu qysh duhet. Ua kisha ditë për nder nëse kish mujt me u arritë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Shiko, të qartësohem për krejt asambleistët edhe për partitë politike që janë të përfaqësuara në Kuvend. Unë i kam premtimet që unë kam dalë në fushatë dhe kam konkurrua me atë program edhe një prej arsyeve, besoj unë që qytetarët e Mitrovicës ma kanë dhënë besimin janë këto, ka shumë jashtë tyre, Komuna e Mitrovicës nuk i ka veç 123 nevoja, ka ma shumë nevoja. Unë po i referohem premtimeve, të cilat janë evidentua, disa aty nuk janë evidentua po janë kryer, se për shembull në atë listë nuk e ke Rrugën “Ali Zeneli”. Nuk i ke Rrugën “Lah Nimani”. Kanë qenë premtimet e mia kryesore. Qysh e kam thënë atëherë po e them edhe sot për kosto financiare i qëndroj mbrapa. Po unë sa jam në informacion, kjo punë ka fillu me u adresu. Për më në detaje, besoj që drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër do të japë sqarime të nevojshme. Po prapë, po e riheskoj koston financiare të këtij projekti, unë i rri mbrapa. Qysh i sigurojmë mjetet, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe procedurat, nuk kanë me qenë problem për ekzekutivin.

Artan Berisha: E nderuara Kryesuesë, i nderuar Kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë dhe ju asambleistë, kemi qenë përfitues të një projekti nga Agjencioni Kadastral dhe kemi nënshkru një memorandum bashkëpunimi ku të gjitha këto, çfarë i përmende Sevdaimi, është përfitues Fshati Këçiç dhe do të rregullohen të gjitha do të thotë emërtimi i adresave, parcializimi, pronarë të cilët kanë qenë me vite me radhë që nuk kanë qenë pronarë legjitim dhe tani do të do kthehen të gjitha.

Sevdaim Uka: Nuk është kërkesë lokale, është gjithë përfshirëse, nuk po dua me qenë lokalist, është e nevojshme për gjithë komunën, se në Vushtrri ka përfundua edhe në Skenderaj, kemi mbet vetëm ne.

Erseka Barani: Atëherë përshëndetje për të gjithë, nuk dua të zgjatem meqenëse nga të gjithë parafolësit e mi pak a shumë u përmendën të gjitha problemet dhe pikat që kanë qenë të përfshira në këtë buxhet. Gjatë analizimit dhe krahasimit të buxhetit të vitit 2024 me atë të vitit 2025, me keqardhje mund të them se ndryshimi është minimal. Desha të ndalem tek përcaktimi i prioriteteve ku thotë se prioritetet kryesore janë arsimit, shëndetësia, infrastruktura e digjitalizimi i shërbimeve. Sa për teori, natyrisht që pajtohem, por kur dalin në praktikë, dallojnë që secila prej tyre lë shumë për të dëshiruar. Investimet kapitale në arsim do të thotë në draft-buxhetin e vitit 2024 kapin shumë prej 1,370,000.00 € Pak më herët parafolësja tregoi për problematikat bazike që i ka brenda një ore të saj, mos të flas nëse dalim nëpër shkolla tjera e konkretisht në shkollën “Abdullah Shabani”, ku është një shkollë e frekuentuar me mbi 1000 nxënës por mosrealizimi i këtyre projekteve të parapara në vitin e kaluar që ngjan si një copy-paste, Në shëndetësi është fakt, janë realizuar investime në objekte të infrastrukturës, por mungesa e personelit dhe mungesa e barnave esenciale është shumë e theksuar, fatkeqësisht. Infrastruktura, veç me i përcjellë buxhetet kohë pas kohe, mundesh me i pa që çdo vit janë projektet pothuajse të njëjta vetëm ndërrim i pozitive dhe emërtimeve të tyre. Ndërsa për digjitalizim, me disa E-kiosqe shtesë nuk besoj që zgjidhet problemi sepse nuk kemi ende as kabinete shkollore, e-shkollori nuk funksionon, sistem për rezultate të analizave nëpër QKMF-në nuk ka, kështu që nuk besoj që ka ndonjë progres sa i përket digjitalizimit të shërbimeve. Vazhdojmë tek identifikimi i kërkesave, thuhet se ky buxhet është i hartuar në bazë të kërkesave të qytetarëve, mirëpo sipas meje nuk e di sa keni qenë gjithëpërfshirës kur janë realizuar vetëm katër dëgjime buxhetore. Ky numër duket që është vetëm sa për të përmbushur obligimin ligjor e aspak realizimin e përfshirjen e tyre në draft-buxhet. Për ta faktuar këtë, iu them se në dëgjimin e fundit buxhetor, në bazë të atij raporti që ju e keni sjellë figurojnë vetëm kërkesat e qytetarëve dhe pothuajse asnjë përgjigje se a janë në proces apo do të përfshihen në buxhet e kryesisht këtë e them sa i përket kërkesave të grave ndërmarrëse që janë në Komunën e Mitrovicës, të cilat secila prej tyre ka kërkuar një subvencion, apo ndihmesë sa i përket blerjes së pajisjeve për veprimtaritë e tyre. Dhe për fund, vetëm dua t'ua rikujtoj gjithë kolegëve të mi se veç këtë vit, minimumi nga tri-katër herë kemi bërë ridestininim të mjeteve që do të thotë ndoshta edhe ato projekte që këta i cekën që s'janë realizu këtë vit ne e kemi bërë ndryshimin e destinimit të tyre me kërkesë të ekzekutivit, kështu që pak a shumë po duket që ky buxhet do të jetë fiktiv, në qoftë se vazhdon edhe vitin e ardhshëm të ketë ridestininime aq shpesh.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Zonja Barani po, prioritetet kanë qenë arsimit, shëndetësia, infrastruktura, digjitalizimi. Tash po t'i numëroj me radhë, nëse dikush nuk do me pa ose s'do me pranë është temë tjetër. Po përmendi shkollat: Elena Gjika në Tunel të Parë, Bedri Gjinaj, Eqrem Çabej, Hasan Prishtina, Arkitekt Sinani, Skënderbeu, Çajupi, janë të ndara mjetet dhe uroj që të ndodhë, nuk jam unë këtu me thënë ndodhë pa ndodhë ngjarja për Gjymnazin edhe Shkollën e muzikës. Le të del, le të ma thotë dikush, veç le të ma fakton nëse për tri vjet qeverisje kanë ndodhë kaq investime në arsim në të kaluarën. Uroj që në të ardhmen të ndodhin ma shumë, nuk jam i sigurt. Te digjitalizimi, mendoni qysh ka qenë situata këtu në komunë me shërbime, në çfarë kushte kanë punu të punësorit dhe në çfarë kushte kanë marrë shërbime qytetarët? E-kioskat, Shipol, te stacioni i autobusëve, Tunel të Parë, në Kçiq. Te shëndetësia, s'di më cila ka mbet. Me Vllahi, me Zabërgj, me Bare, me Bajgorë, me Rashan, me Stantërg ambulantë e re, me Iliridë, me Shupkocv, me Koshtovë, me vizita shtëpiake, me rritje të buxhetit për barna esenciale, sigurisht se ka mundësi edhe për më shumë. Prandaj, e kuptoj këtë pjesën që duhet më shumë edhe më mirë, edhe pajtohna. Po të arriturat janë të pamohueshme, janë të prekshme, janë konkrete. Për atë pjesë, flas ballëhapur. E tash a kisha pas dëshirë dhe a ka nevojë për më shumë gjithmonë.

Naser Muja: Edhe pse të gjitha thuajse u cekën nga parafolësit, ky buxhet është një buxhet që është vetëm vazhdimësi e buxhetit paraprak, përjashtim dy a po tri të tjera që kanë hy. E kuptojmë ato që mbesin pa u realizuar, po jo pafundësisht pa realizuar. Për shembull, te Rruga "Ali Zeneli" unë çka munda me vërejt është bërë katër herë planifikim në vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025, veç për vitin 2024-2025 janë 740,000 € nuk e di vlerën totale, nuk e arrin një milionëshin. Tjetër çka ke me rëndësi të cekët tek unë, te fshatrat e Shalës së Bajgores, kam shumë kërkesa, kam shumë njerëz që takoj atje dhe shumë pak janë të përfshirë, janë 34 fshatra. Çka u bë investim, u bë një investim i vogël. Ka qenë në planifikim Bajgora çdo vit 40,000- 50,000 €, sot me 40,000 € s'po mundemi të ndreqim një shtëpi. Kisha thënë t'i gjejmë disa mjete tu dilni në përkrahje pak më tepër. Për shembull, te kodi, ku e keni shti blerja e semaforëve, pajisjeve tjera 136,000 € s'di a keni bërë ndonjë analizë ku doni me i vendosë ata semaforë. Unë e kisha thënë aty të heqim 1000,000 € e të vendosen për Shalë të Bajgorës, pa marrë parasysh fshatin ku. I ke disa kërkesa të fshatit Kovaçicë, atje një rrugë ka filluar të shembet dhe ka qenë ai profesori disa herë aty, nuk e keni marrë parasysh, ajo nëse nuk mirëmbahet, ajo shkatërrohet. Atëherë, është detyrë e juaja që t'u dilni atyre banorëve në ndihmë. Te asfaltimi i rrugëve në fshatra dhe qytet, ka qenë mirë të ceken cilat fshatra, 100,000 € Më mirë të hiqet ai kod krejt të punohet, për shembull, një rrugë të përfundohet edhe të vazhdohet vitin e ardhshëm. Kështu, veç po e lëmë 40,000, 50,000€ nuk po realizohet, s'po shkojnë procedurat, po mbetet. Ndërtimi i rrugës Zhazhë-Vllahi është shumë me vend, ka qenë kërkesë qysh prej shumë kohësh, unë bile kam bërë kërkesën, sa ke qenë ministër në financa, por nuk është realizuar. Ujësllësit, i Vllahisë është shumë për keqardhje, pse nuk realizohet? Edhe ujësllësi i Mazhiqit, pse nuk është funksional, nuk e di, në kohën kur kam qenë drejtor unë ka qenë funksional, pse e keni lanë, tutje është për keqardhje. Faleminderit, nuk po hyjë më tepër se u cekën të gjitha.

Oltion Ahmeti: Gjatë këtij mandati si asambleist kam bërë shumë kërkesa. Kërkesat e mia që i kam bërë nuk janë në planifikim të buxhetit. Kisha dashtë të marr një shpjegim nëse kish pas mundësi për lagjen e Zhabarit. A do të përfshihet në buxhet?

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Draft Buxhetin për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027.

**Rezultati i votimit: 22 për, 6 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Draft Buxhetin për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027.**

### **Pika 3**

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/060/01-0029209/21-3 i dt. 29.04.2021.

Flutura Beka Kamberaj: Unë veç kisha dashtë sqarime shitesë prej drejtorisë përkatëse lidhur me këtë pronë. Për shkak se sipas informatave që i kemi i ka marrë disa kërkesa prej pronarit të tokës, me të cilat ka kërku që mu bë rivlerësimi edhe një herë për shkak se i ka pru kontratat noteriale, që fqinjët e tij kanë vlerë më të vogël. Përveç saj, ka pru edhe kërkesa të tjera, me të cilat ka kërku që me bë këmbimi i pronës me vlerë, sipërfaqe të barabartë me vlerën e pronës së tij. Ato nuk i kemi në dosje, e me na e sqaru pak a shumë, për shkak se ne jemi

për me i marrë pronat gjithë atyre, të cilët nuk i kanë kry pagesat, po edhe ata të cilët nuk e kanë kry ndërtimin e objekteve afariste, mbi të cilat ju ka besu prona mirëpo jo individualisht. Unë kisha kërku që mu bë një komision prej pozitës dhe opozitës dhe mu verifiku të gjitha pronat, të cilat nuk janë kry investimet e duhura ose nuk janë bë pagesat e duhura, po jo individualisht mu bë një nga një. Komisioni le t'i verifikon të gjitha dhe grumbull le të propozohen në Kuvend.

Artan Berisha: Po, vendimi është marrë me dt. 29.04.2021. Qëllimi i këtij vendimi ka qenë hapja e rrugës në Bair, sipas planit rregullues Hekurudha dhe janë thirrë në vendimin për hapjen e Rrugës Ali Zeneli dhe Lah Nimani. Ky vendim s'ka të bëjë me këtë pronë që është këmbi, prona në të cilën po bisedojmë është te xhamia e Bairit mbrapa ajo e pjesa e lëshuar, po besoj e keni edhe material me parcelën lartë që është te Fabrika e Duhanit. Besoj që e ke të qartë edhe saktë se keni qenë edhe pjesë edhe e qeverisjes, po besoj. Këtu, me atë vendim, realisht është e cekur edhe inicimi i këtij vendimi nuk është i ligjshëm, e para. E dyta, ka kërku rivlerësim e ka dërgu vetë lëndën e ka rivlerësu pala. Ju ka kthi rivlerësimi, prapë s'ka qenë i kënaqur, mirëpo unë kam qenë i obliguar këtë propozim-vendim për me anulë, gjatë procedurave e kam pa se kjo parcelë është këmbi në formë të kundërligjshme.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Pasi nuk ka ndonjë urgjencë kanë nevojë edhe asambleistët me pa pak më detajshëm, secili prej neve edhe unë po propozoj që e njëjta, nëse pajtohet Asambleja, le të tërhiqet prej rendit të ditës, le të bëhen sqarimet e nevojshme edhe le të vjen në seancën e radhës.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Pika e tretë e rendit të ditës tërhiqet nga rendi i ditës, po vazhdojmë me pikat e radhës.

#### **Pikat: 4, 5 dhe 6**

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Po i vazhdojmë për diskutim pikat 4-5 dhe 6 bashkërisht, të cilat kanë të bëjnë me këmbimin, ndërsa kur vijmë te votimi, e votojmë secilin veç e veç.

Pas sqarimeve të pikave Drejtori i DGJKP-së z. Artan Berisha, Kryesuesja e mbledhjes e hapë diskutimin.

Faruk Mujka: Fillimisht, nuk desha me e zgjat debatin në pikën e kaluar, thashë t'i kryejmë më shpejt, po Kryetari e përmendi prapë atë borxhin, po rritet ai borxh herë gjashtë, herë dhjetë që e ke trashëgu, Kryetar na e dimë që është dy pikë dy, ti sa të duash thuaj, rritë deri në dymbëdhjetë, por ajo ka qenë dy pikë dy. Edhe apet e them ka qenë për fajin tënd derisa ke qenë ministër për kontratat kolektive, na i ke bartë komunave, s'kemi pasë, në atë borxh po thirresh. E tash më intereson, sa ke me i lënë edhe ti borxh, kështu që kjo është shumë relative. Edhe në anën tjetër pastaj e the 8 vjet keni bë në Rrugët "Ali Zeneli" edhe "Lah Nimani", Po bre, ndoshta edhe tetë vjet por të paktën i ke gjet 70% të kryera Kryetar. Ke thënë për gjashtë muaj e kryejnë, më trego çka ke ndërmarrë. Ato asfaltimet që i ke bë te rruga "Lah Nimani", që dy vjet i ke bë ato fotografi, deri kanë dalë atë hapjen solemne të "Lah Nimani" e shtojshit, e hekshit, e lajshit asfaltin e shtojshit prapë. Edhe të Ali Zeneli, asgjë nuk keni bë me të, e keni larë, ujërat e ndotura prapë po notojnë mbi të. Është çështje tjetër, po du m'u kthi te kjo pika, po s'munda Kryetar pa reagua për atë. Sa i përket këmbimeve këtu janë dy çështje shumë esenciale, ma merr mendja për të gjithë neve. E para, të gjitha subjektet, së paku për këto tri legjislaturat e fundit, jemi pajtu që ta shtyjmë këtë proces përpara edhe pse rrugës gjithmonë ka pasë ndërskambësia të vogla, po të gjithë jemi pajtu që te këto dy rrugë duhet me ec përpara sepse me të vërtetë unë personalisht, po edhe të gjithë, mendojmë se këto dyja të janë arteriet kryesore të Mitrovicës edhe kushdo që është në ekzekutiv është detyrë e secilit prej neve me ndihmua hapjen e tyre. Kështu që nuk ma merr mendja që duhet me pas ndonjë hezitim në këtë çështje. E çështja e dytë është tash a është duke shkuar krejt gjithçka në rregull, në këtë proces. Personalisht, mendoj që nuk po shkon. Posaçërisht pas atij këmbimi që e kemi bë vitin e parë, kur ka pasur ndryshime në atë çka kemi vendosë ne këtu edhe pastaj në terren ndërtimet, mbindërtimet e tjerë nuk janë me ato çka kemi vendos ne, qysh kalon kjo tjetra, nuk e di se nuk jam i thirrur për atë punë, është dikush tjetër. Unë jam i thirrur së bashku me kolegët tanë, me iu ndihmu qytetarëve edhe qytetit me zgjidh një problem jetik për ta, hapjen e këtyre dy rrugëve dhe parimisht ne jemi pro këtyre këmbimeve, por normalisht me rezerva rreth implementimit të tyre, atë e shohim pastaj edhe pse unë për vete nuk kam shumë informata.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Sa i përket obligimeve të prapambetura të papaguara nga e kaluara unë i referohem shifrave edhe të dhënave zyrtare nga thesari i shtetit. Për hir të korrektësisë gjithmonë e theksoj



që një pjesë e konsiderueshme e këtyre obligimeve të prapambetura, të papaguara më herët, që janë barrë për buxhetin e Komunës së Mitrovicës, nuk kanë të bëjnë me qeverisjen lokale. Një pjesë, nëse doni, ua them që e kam gjetë nëpër fioka, po e them janë pjesë e qeverisjes paraprake mirëpo pjesa më e madhe ka të bëjë me kontratat kolektive të pazbatuara dhe janë, po e ritheksoj edhe po e marrë për obligim në një nga seancat e radhës me sjellë raportin sa komuna e Mitrovicës për këtë mandat ka paguar obligime të prapambetura nga e kaluara. Në emër të gjithave, edhe kontratave, edhe përmbarimet, edhe të gjitha tjerave. Nuk kam nevojë me i shtu kurrëgjë, veç qysh është, të dhënat prej thesarit të shtetit. Çka kemi bërë te Rruga “Ali Zeneli”? Projekti teknik nuk ka ekzistuar. Sigurimi i mjeteve financiare, procedurat e prokurimit, ekzekutimi i punimeve, këto i kemi bërë. Ka qenë dhe vazhdon të jetë punë sfiduese puna e pronave, është punë e ndjeshme, shumë komplekse dhe jam i lumtur që po prodhohet situata ku po mundësohet kyçja në këtë rrugë. Prapë nuk është krejt sepse te Gërxhaliqë ende nuk është tejkalu problemi, pjesët tjera po besoj që janë të përfunduara. Drejtori ke më mirë me dhënë një sqarim shtesë: çka është duke ndodhë? E para është vendim i kësaj asambleje komunale që rruga është shpall me interes publik. Iu kemi drejtu Ministrisë së Financave për vlerësim të pronave, e ka kry vlerësimin e pronave Ministria e Financave. Kemi marrë konfirmim të ligjshmërisë se cila është rruga sa i përket trajtimit të vlerësimit të pronave, qysh shkojnë, cilët janë hapat, është konfirmimi ligjor. Zyrën Ligjore e kemi konsultu dhe kemi kërku opinion ligjor që gjithçka të jetë ligjore dhe transparente. Po flasim për këmbim të pronave të njëjtin vend, të njëjtën zonë. Nuk po flasim as për ndërtime, as për çështje tjera. Po flasim veç për këmbim të pronave. Çka unë e kam thënë dhe qëndroj në ato, prona ku ka qenë e ndërtuar objekti i shkollës së muzikës derisa unë jam kryetar e ka destinacionin për oborr të shkollës së muzikës. Nuk po lëshohem më tutje, unë nuk e them që ka më shumë na kemi përgjegjësi të ndryshme, po përgjegjësitë i kemi të ndryshme, mirëpo qëllimin nuk mund me thanë që unë ose PDK-ja e ka më shumë se LDK-ja, Vetëvendosja, Partia e Drejtësisë, AKR-ja AAK-ja, Iniciativa Qytetare, nuk jam duke e thënë këtë. Nuk jam duke luftu për diçka me marrë bajraktarizma në këtë punë, përgjegjësitë i kemi të ndryshme. Unë besoj që qëllimin e kemi të gjithë të njëjtë, me e bërë më të mirën të mundshme. Kushdo që me fakte të prekshme mundet me thënë që ky hap, që kjo procedurë mendojmë që duhet me qenë ndryshe, jam i hapur me dëgjua. Unë, besoj edhe ju, në pikën paraprake mu shkakti një konfuzion. Besoj edhe juve iu shkakti konfuzioni. Atëherë nuk kemi nevojë. Pse? Për cilën është arsyeja? E bëjmë kurdo që të ndodhë në procedurë ligjore, transparente, në dobi të qytetit dhe qytetarëve të Mitrovicës a borxh hyjmë, zoti Mujka, raportin ka me sjellë, po sinqerisht janë shumë dhe nuk iu referova, nuk gjuajta fajë, pata qëllim me tregu një realitet, se përnjëmend brenda një mandati qeverisës me të mungu prej mjeteve rreth dhjetë milionë plus minus është thuar se përafërsisht buxheti kapital dy vjet. Unë po du me besu që po vij në fund, as vetë s'e kam qartë punën, po po du me besu që po vij në fund edhe mos me pas më.

Flutura Beka Kamberaj: Ne si grup parlamentar i LDK-së edhe në mandatin e kaluar, po edhe në këtë mandat vazhdimisht i kemi përkrahë edhe i kemi votu shpronësimin e pronave për lirin e rrugëve “Ali Zeneli” dhe “Lah Nimani”, të cilat rrugë janë me interes për qytetarët e Mitrovicës si për zgjidhjen e problemit për këmbësor për fëmijë, për të moshuar, për qytetarë, ashtu edhe për lehtësimin e komunikacionit për vetura, po edhe për zhvillim të bizneseve, të cilat veprojnë në atë pjesë. Prandaj, ne e përkrahim votimin e shpronësimit të pronave për lirim të këtyre dy rrugëve.

Vesel Neziri: Po hyj në vitin e dymbëdhjetë që vazhdoj punën këtu si anëtar i Kuvendit, në qoftë se një ëndërr kam me e pa prej Kuvendit, kom me pa ëndërr rrugët “Ali Zeneli” edhe “Lah Nimani”. Një gjë që më kish mbet zhig që në këtë rrugë të rregullohet, është një banesë kolektive, ku qytetarët e Mitrovicës janë mashtruar nga ndërtuesit dhe ende ka familje që jetojnë me qira dhe ajo banesë kolektive nuk po përfundon. Ana ligjore s'po na lejon me i ndihmu ata. Humanizëm na mundëm me dhënë sa të dojmë prej këtu, po nuk po mundëm me rregullu punën. Kisha pas dëshirë që në kontakte me shoqata humanitare, t'ju kërkohet ndihmë që ai objekt të rregullohet në atë rrugë aty dhe të ecet tutje. Prandaj, unë po mendoj që sot po përfundon një cikël i gjysmë përfundim dhe kjo rrugë do të fillon të hapet dhe do të jetë edhe e mirë, jo vetëm për neve, po të gjithë ata që vizitojnë Mitrovicën sepse jemi ngulfat nga komunikacioni i tepërt. Uroj që kjo rrugë dhe kjo punë e nisur përfundon dhe sa më shpejt Mitrovicës t'i hapen dy arteriet kryesore, për të cilat ka shumë nevojë qyteti.

Naser Muja: Me sa e di unë projekti për Rrugën “Ali Zeneli” ka qenë, disa banorë aty janë shumë të pakënaqur me disnivelelin që u ka ardh te objektet. Arsyen nuk e di pse ka ardhë. Nëse u bë një ndërhyrje në projekt, atëherë është dashtë me ia përshtatë atyre ndërtesave, si në vend, unë e po e di që ato banesa me siguri

janë disnivele i tyre, por projektet duhet me i përshtatë së për atë po ndërtohet ajo rrugë. Kështu që pata dëshirë me ditë edhe sa shpronësime kanë mbet në Rrugën “Ali Zeneli” dhe sa në Rrugën “Lah Nimani”, për me ardh përfundimi i tyre edhe mos të ngasim me shtru asfalt sot e nesër me heqë, përfundohet një herë përgjithmonë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Te shpronësimet, z. Muja, e thashë, në Rrugën “Ali Zeneli” pas përfundimit të këtyre vijmë deri te shtëpia e Gërshalive, që është një situatë mjaft komplekse që e dini edhe ju. Te Rruga “Lah Nimani” profesorëshës ia kam dërgu rastin në procedurë ligjore edhe njoftimin, po edhe vendimin preliminar për shpronësim pasi që, pas shumë tentativave, nuk ka pas mirëkuptim që e njëjta të shkon me këmbim apo të bëjmë marrëveshje në koeficient të ndërtimit. Kemi fillua procedurat në bazë të ligjit për shpronësimet. Vendimi preliminar ka shku, i presim afatet, edhe afatin e ankesës dhe në moment kur vjen koha për vendim përfundimtar ne do ta marrim edhe vendimin përfundimtar dhe pastaj do të eliminohet ajo pengesë. Pengesa e radhës që s’është përfundu është te shpija te Korenicët dhe në fund në dalje janë dy mundësi, është mundësia me lëviz në të djathtë që m’u kriju qasja në Rrugën “Agim Ramadani” që është më e përafërt me u kry, tash them të drejtën, le të më falin ndoshta për emërtimin, por më kanë thënë te shtëpia e Zanës, ashtu për shkak se ana e majtë me u hapë, domethënë është shumë më shumë problematike edhe me thonë se ndoshta shkon shumë kohë e gjatë edhe mos me mujt me u mbërri. Në rrugën “Lah Nimani” po flasim për tri prona, për një pronë që është e profesorëshës Sabile, që i ka shku vendimi preliminar, prona e dytë e cila është te Korenicët e tash në fakt është pronë e një ndërmarrje dhe, në fund, dalja a do të lëvizim në djathtë apo në të majtë këto janë situata që duhet me i trajtu, unë sinqerisht i mirëkuptova edhe asambleistët edhe për kohëzgjatjen e punimeve dhe pengesat edhe të gjitha këto m’i kanë thënë edhe mua, edhe unë i kam pa, mirëpo realisht kur po bëhet sidomos vendosja e pusetave, kanalizimet e reja, ujësjellësi i ri po është punë shumë më e madhe se asfalti. Ju jeni këtu disa prej juve inxhinierë që jeni shumë më të avancum se unë në këtë fushën profesionale, po kur po vjen te shtresa e asfaltit, puna pothuajse po është e përfunduar. Po derisa po vie te asfalti, e ka kohën e vet, tash dëshira është, edhe nevoja përveç dëshirës, po këto janë situatat.

Ekrem Sadiku: Kam vetëm një kërkesë në lidhje me sqarimin për propozim vendimin, në ranglistë i dyti, ku ka të bëjë me parcelën e komunës me metrazh 14 m<sup>2</sup>, që është për këmbim me parcelën në pronësi të ARSI kompani 11 m<sup>2</sup>, deshta një sqarim drejtor, vlerësimi është bërë prej ministrisë dhe çmimorja e vlerësimit natyrisht që është e dallueshme për shkak edhe metrazhit që ia dallon, mirëpo ky kompensimi a do të ndodhë apo si do t’ia bëjnë, a do kompenson 11m<sup>2</sup> me 11 m<sup>2</sup> apo 14m<sup>2</sup> me 11m<sup>2</sup>. E dyta, ka kështu një lloj kritike për juve rreth formularit për procedim të lëndës për nënshkrim, secili formular ka ndërhyrje te protokollit atje. Thotë ky është dokument zyrtar, i nderuar dhe nuk besoj që ju kish marrë shumë kohë sikur të hyni dhe të procedoni një dokument origjinal dhe të mos ndërhyri në këtë formë, sepse te datat që i keni 05.07.2024 është origjinali i shkruar në Uord, ndërsa keni ndërhy me kimikë, ku në protokoll e keni bërë 23.07.2024. Dhe këtu i ke rend te pjesa dërmuese e formularëve për procedim të lëndës për nënshkrim.

Edison Tërnavë: E nderuara Kryesuesë, Kryetar, të nderuar kolegë dhe ju të gjithë asambleistë, po Ekrem, çështja e m<sup>2</sup> të cilat janë cekur në këmbimin e Rrugës “Ali Zeneli” të gjitha parcelat që janë pengesë jashtë vijës rregullative, planit rregullues urban Qendra është dashtë që patjetër që të mos jetë pengesë për rregullimin ose krijimin e mundësisë së shtrimit të Rrugës “Ali Zeneli” që të këmbëhet metër për metër në bazë vlerësimit, që është bërë në ministri. Nëse ka qenë 14m<sup>2</sup> e Komunës dhe 11m<sup>2</sup> pronës private këmbëhet 11m<sup>2</sup> me 11m<sup>2</sup>, për shkak se edhe vlerësimi që ka ardhë dhe është vlerësuar në vlerë të njëjtë, domethënë nuk lejohet ligjërisht që të shitet prona e komunës ose caktohet vlerë që të paguhet shtesë për pronën ose për metrat shtesë. Kjo është sa i përket pyetjes që e bëre, domethënë për pjesën 11 m<sup>2</sup>, që është jashtë vijës rregulluese. Domethënë, të gjitha hapësirat që janë jashtë vijës rregulluese, pronë private, jemi mundu që t’i fusim me një parcelë të pjesës, që të mos kemi pengesë për hapjen e Rrugës “Ali Zeneli”. Janë brenda vijës rregulluese, nuk na pengojnë fare, veç ato që janë jashtë vijës rregulluese, që mundën me i kriju problem Drejtorisë për Shërbim Publike për implementimin e projektit. Pyetja e dytë te çështja e datës, ky është dokument që është përgatitë prej Zyrës Ligjore, Zyra e protokollit ka intervenu, nuk po mundem me ditë çka ka ndodhë se po e shoh edhe unë 23.07.2024 është diçka, po vetëm ky, sepse kompletimi i dokumentacionit ka zgjatë derisa është kompletu dhe protokollit ka qenë i njëjtë.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Ju falënderoj secilit për kontributin në diskutim. Po vazhdojmë me miratim të propozimeve secilën veç e veç.

Kush është që miratohet Propozim-vendimi për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K.

**Rezultati i votimit 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K.**

Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K. duke përfshi dhe objekti për banim/afarizëm.

**Rezultati i votimit 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K. duke përfshi dhe objekti për banim/afarizëm.**

Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Blerim Emini.

**Rezultati i votimit 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Blerim Emini.**

#### **Pika 7**

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për miratimin e ndryshimit të emërimit të shkollave të mesme të larta profesionale në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim vendimin për miratimin e ndryshimit të emërimit të Shkollave të Mesme të Larta Profesionale në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional.

**Rezultati i votimit 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për miratimin e ndryshimit të emërimit të Shkollave të Mesme të Larta Profesionale në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional.**

#### **Pika 8**

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Raportin e performancës komunale për vitin 2023.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Raportin e performancës komunale për vitin 2023.

**Rezultati i votimit 24 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Raportin e performancës komunale për vitin 2023.

#### **Pikat: 9, 10 dhe 11**

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Janë tri propozime për subvencionim të organizatave të dala nga lufta. Materialin e keni secili para juve. shoqatat nuk kanë marrë sivjet subvencione, marrë parasysh që të trijat e ushtrojnë thujse aktivitetin e ngjashëm, marrin pjesë nëpër aktivitetet e ngjashme, të tri kërkesat kanë ardhë me shumën e njëjtë prej 3,300 €subvencion. Në diskutim me ekzekutivin, këto të holla munden me u pagu nga shërbimet sociale tek Kodi subvencione edhe transfere, Nëse ka dikush diçka për diskutim, po e hap.

Hamdi Hasani: Meqenëse unë jam anëtar i njëjës prej kryesive të këtyre organizatave dhe çdo takim që takohemi, përballemi me vështirësi të ndryshme, duke pasë parasysh se tani këto vitet e fundit po përballemi me një gjendje jo të mirë si organizatë kryesore në nivel qendror të këtyre strukturave, të këtyre organizatave, duke e ditë secili prej nesh çka përfaqësojnë, por besoj atyre që nuk e dinë duhet me ju kujtu që gjithçka edhe këto karrige edhe këto ulëse tona që jemi ulur këtu është diçka e kësaj pune, është diçka e meritë e këtyre organizatave që përfaqësojnë atë lëvizje, përfaqësojnë atë luftë,. Dhe për këtë çështje duhet të jemi pak ma të

matur. Unë kisha kërku prej drejtorisë edhe Kryetarit, në qoftë se ka mundësi me u rritë këto shuma, duke e marrë parasysh se Niveli Qendror Organizatën Qendrore të Veteranëve, i ka lënë pas dore duke bërë manovrimet të llojllojshme, duke i largu veteranët prej pagës minimale, duke largu gjitha çka kemi pa për çdo ditë dhe duke u mundu në çdo formë t'i anashkalojë këto organizata. Unë kërkoj që këto kërkesa, të atyre tri organizatave në nivel lokal, t'i rrisim nëse kemi mundësi, sepse kanë nevojë, përballemi me telashe të ndryshme sa herë që kemi një mbledhje të organizatës së veteranëve, aty ku jemi, sigurisht e kanë edhe dy organizata tjera që janë të njëjta këtu. Kjo ishte kërkesa nëse ka mundësi, po m'u rritë këto shuma, të paktën minimumi më u bë nga 5,000 €e më vonë të shohim nëse kemi mundësi me nda diçka ende për ta.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Nëse jemi dakord po vazhdojmë me proces të votimit. Po shkojmë me votimin e secilës kërkesë veç e veç:

Kush është që të miratohet kërkesa për mbështetje financiare për Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, në vlerë prej 3,300 € kush është për?

**Rezultati i votimit 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për mbështetje financiare (subvencionim) të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së.**

Kryesuesja vuri në votim Kërkesën për mbështetje financiare (subvencionim) të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së.

**Rezultati i votimit 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për mbështetje financiare (subvencionim) të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së.**

Kryesuesja vuri në votim Kërkesën për mbështetje financiare (subvencionim) të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

**Rezultati i votimit 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar me votë unanime Vendimin për mbështetje financiare (subvencionim) të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së.**

## **Pika 12**

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Raportin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë.

Faruk Mujka: Ky raport, nuk është ai çka e këna kërkuar sipas procesverbalit të cilin e votuam në fillim të mbledhjes sepse aty decidivisht shkruhet: Drejtori dhe Kryetari i kryejtën punët e veta i votuan pikat edhe ecën. Kërkesa, Kryesuese ka qenë Rrugët "Ali Zeneli", "Lah Nimani", "Mbretështa Teutë" dhe Rruga e Shipolit a kanë përfunduar, kur përfundojnë, a kanë pranime teknike, nëse jo, pse dhe a janë paguar. Kështu ka qenë kërkesa kur është bërë në mbledhje edhe tash drejtori çka na ka prezantuar, respekt kësaj për sasi dhe koloritin e fotove por nuk është raport i kërkuar sepse në 58 faqet e këtij raporti nuk ka asnjë informatë për këto çka është kërkuar. Në faqen 10, fillon listimi për planifikimin e projekteve kapitale për vitin 2024, e që unë e thashë edhe më përpara është komplet copy-paste e investimeve kapitale për vitin 2025. Unë mendoj që duhet me qenë projektet e reja, aty ishte edhe ajo ura që e përmendi më herët kolegeja. Unë ende nuk po mundem me e kuptua se me të vërtetë është një bashkëfinancim ndërmjet komunës, MZHR-së edhe Demos-it, edhe krejt këto tri palë nuk e kanë bërë të mundshme me u krye një urë, që dorën zemër nuk e ka ndonjë kosto apo ndonjë mund të madh që duhet me u kriju. Ndoshta kishte me qenë mirë me u shkru edhe pse aq shpesh po ndërrohen komisionet pranuese të punëve. Tash, ose nuk po e dinë punën këto komisione, ose ndoshta nuk po duan me i dëgjuar, me i pranuar punët të cilat nuk i përmbushin standardet. Te Rruga "Lah Nimani", thotë matje gjeodezike që i kena paguar, nuk di që as diku në perëndim janë paguar më shtrenjtë ato matje gjeodezike për 100 m rrugë dy vite, pashë edhe zgjedhje inovative të trotuarit, edhe ndërimi i asfaltit edhe fotot e Rrugës "Ali Zeneli", por jo edhe këto problemet që janë krijuar tash. Nuk pashë foto të dy rrugëve, që nuk ua di emrin, mirëpo më vjen keq, por është Rruga "E hekurudhës" edhe kjo Rruga që çon te Interexi, të cilët heroikisht po i rezistojnë asfaltimit të "Bagerit". Dhe ua them dhe dita ditës po i dëmtojnë veturat, përnjëmend janë rrugë të forta, kështu kryeneçe, edhe kompania s'po dorëzohet. Pashë punimet edhe në shesh, se edhe në shesh keni bërë investime, faktikisht betonime të pa kuptimta, po asnjë këtu nuk pashë asnjë foto kësaj fontanës këtu, e

cila do t'i konkurroj fontanës së Agim Bahtirit, e cila nuk ka qenë e Agim Bahtirit kurrë, ka qenë e KFC-së, po keni pasur qef me e thirr e Agim Bahtirit, të cilin e keni heqë me aq vrull brenda një dite, kështu për njëzet e katër orë, kështu me heqë me rrënjë. E tash po presim këtë fontanën e re, e cila nuk është as në projektin e 2024, as në projektin e 2025, po mbihet kadalë dale, nuk po them që nuk është bërë punë, por informatat, kërkesat, që i kemi bërë në këtë raport nuk janë. Unë çfarë kam mësuar prej këtij raporti, i kam mësua punët që i ke bërë të dokumentuara me foto, por ato punë që s'i ke bërë normal që as unë ndoshta nuk i kisha qitë, po së paku këto informatat që i kena kërku, nuk janë.

Naser Muja: Pasi që jemi te raporti i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, e cekëm edhe ma lart se është veç një përshkrim i atyre raporteve të mëparshme. Si e ceka në fillim, ndërtimi i rrugëve në Fshatin Bajgorë ka qenë edhe në vitin paraprak edhe këtë vit. Unë nuk kam parë që është duke u punuar diçka ndoshta në procedurë është, por nuk e dimë më tutje, në fshatin Zasellë është e njëjta, unë në terren nuk po shoh punime. Ndërtimi i Rrugës “Dëshmorët e Kombit” në Shipol, a është afër, a do të prehet shirit aty, çfarë po ndodhë nuk e dijmë, kualiteti i punëve është mjaft i dobët, shtyllat elektrike në mes të rrugës, kabëzat nuk e dimë sa m<sup>2</sup> i ka pas të reja sa të vjetra, nuk dihet as a është punuar e re, as sa është e vjetër. Rregullimi i Bulevardit “Isa Boletini” edhe këtu kemi pas dëshirë me ditë një sqarim se çfarë tenderi keni hapur, sa ka qenë vlera e tij edhe çka është punuar me këtë tender, mbasi që në planifikim nuk e keni pas. Zgjerimi i ri i kanalizimit dhe pusëve në Shalë, 70,000 € atje s'e di çka ke menduar, prej tunelit lart, kanalizime s'ka, nuk e dimë tutje. Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Shalë për këtë vit, unë deri tash nuk kam parë asnjë lëvizje. Ato që janë kryer në përfundim, kemi menduar që ato me u përfshi në raport. Shtegu te biçikletat, te mirëmbajtja dhe shenjzimi horizontal dhe vertikal, 2000vm<sup>2</sup>, në rrugën Mbretëresha Teutë, nuk e di çka keni dashtë me këto, unë e di që aty ka qenë e paraparë që me projektin e rrugës me u bë ajo e jo me projekte tjera. Edhe te liqeni po shkruan 3000m<sup>2</sup>, keni vendosë skajor që për një vjet, dytin vjet shkrihen, i keni heqë skajorët e bardhë, keni gjet skajor çfarë nuk e vlen me e qitë as në një trotuar te shtëpia.

Elidiana Budini Haziri: E pashë materialin, e pashë se sa është punuar. I kam vetëm nja dy pyetje edhe pse e di që nuk është pika pyetje dhe përgjigje. Çka po bëhet me liqenin e Mitrovicës, që u kthye në një moçalishte? që kundërmon erëra, që të hanë mushkonjat, Liqeni deri dje ka qenë atraksion për banorët, jo vetëm të qytetit të Mitrovicës po dhe të qyteteve të tjera, sot është kthyer në një moçalishte që kundërmon. A e keni në plan me bërë diçka për atë Liqe, dhe përkundër asaj që kemi dhënë prej këtij Kuvendi, edhe pare për mjete të posaçme për pastrim, mirëpo gjendja këtë verë ka qenë më e keqja. Pyetja e dytë për drejtorin shkon, e kemi ngritur edhe më herët këtu në Kuvend, si pyetje dhe si kërkesë, unë dhe kolegu im, z. Muja, tek hapësira gjelbëruese të “Desi”, zonat prapa “Desit”, prej momentit që keni fituar zgjedhjet e keni demoluat atë vend, aty ka qenë një mini-parking, që nuk ke mundur të gjes asnjë bisht cigare, me një kënd lojërash për fëmijë që ka pas bari dhe gjelbërim dhe lule në të dyja anët, prej ditës që i keni fituar zgjedhjet më nuk u kujdes askush për atë vend, sot është i demoluat. Unë e di që më shumë kushton mirëmbajtja ndonjëherë sesa ndërtimi por në vazhden e punëve tuaja të mëdha, po mendoj t'i ruajmë ato që i kemi si pasuri e mos t'i lëmë të shkatërrohen deri në atë ditë qysh janë bërë, se është fatkeqësi.

Nafije Rexha! Në të vërtetë ishte një ditë produktive, jam shumë e lumtur. Një seancë që ia arritëm me i votu disa vendime shumë të rëndësishme, sidomos ju e dini që kur përmendet sfera e arsimit edhe kur aty ka rritje atëherë për mua është një kënaqësi që nuk di me e përshkruar, s'kam çfarë me bë se jam pjesë e asaj kategorie dhe ndihem shumë mirë. Për sa i përket parcelës te “Desi”, znj. Elidiana nuk ishte më herët, aty do të fillojë çerdhja, dhe besoj që ai do të kthehet në një atraksion, procedurat kanë përfunduar, aty do të fillojë së shpejti çerdhja e fëmijëve. Urime të gjithëve, ju dëshirojë një ditë të mbarë dhe punë të suksesshme në vazhdimësi ashtu qysh e patëm deri më tani.

Elidiana Budini-Haziri: Unë nuk po di a jemi në koordinim, unë nuk po flas për ato që do të ndërtohen, por për ato që po shkatërrohen.

Fisnik Krasniqi: I nderuar Nënkrjetar, anëtarë të ekzekutivit, të nderuar kolegë të asamblesë, sinqerisht, drejtor të përgëzoj për raportin dhe për punën gjatë vitit, po edhe gjatë tërë këtyre viteve juve, edhe gjithë ekzekutivit. Fatmirësisht, erdhi momenti me diskutu për punë, e me i ikë pak atij polarizimi në nivel epidemik që është bërë tash edhe në nivel lokal. Po unë e di një të sigurt që ky polarizim nuk zë vend tek qytetari i Mitrovicës. Mbas dhjetëra dekadave po hapet Rruga “Ali Zeneli”, super investim, Rruga “Mbretëresha Teutë”, Rruga e Shipolit, krejt këto janë investime të qeverisjes komunale që tash po ndodhin, Po, saktë se nuk ka

ndodhë më herët. Historia e këtyre rrugëve fillon me neve, ka me mbet me gjenerata që kanë me jetu këtu në Mitrovicë, prej Rrugës “Mbretëreshë Teutë” sot dilni shikoni çka ka ndodhë në në Shipol, në rrugët “Ali Zeneli”, “Lah Nimani”, kështu qe faleminderit krejtve.

Granit Tmava: I nderuar Nënkyetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar shoqëri civile, media. Nuk po dua me qenë shumë i gjatë sa i përket Raportit të punës së Drejtorisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës për periudhën janar-gusht, Raporti i punës nuk është vetëm një raport e konsideroj më shumë sesa një raport. Për mos t’ju marrë kohë, po dua me u ndërlidh direkt tek pyetjet e z. Mujka, i cili pyeti për rrugët “Ali Zeneli”, “Lah Nimani”, “Mbretëresha Teutë”, “Agim Ramadani-Katana”, Urën, Sheshin, Shipolin, këto janë projekte, në të cilat më bëjnë me u ndie shumë mirë, këto janë projekte, të cilat janë të rëndësishme së veçantë për Qytetin e Mitrovicës, janë projekte, të cilat do të ndihmojnë në zhvillim ekonomik, në përmirësim të jetës në shumë sfera qytetit dhe qytetarëve e Mitrovicës. Fillojmë me Rrugën “Ali Zeneli”, e kanë bërë projektin detal teknik, i kam filluar procedurat, i kam filluar punimet, kanë bërë rregullimin e sistemit fekal atmosferik, kam bërë zgjerimin e ndriçimit publik, janë duke u bërë vendosja e hidrantëve në rrugë, është duke u bërë asfaltimi i shtresës së parë në rrugë, është një rrugë shumë e rëndësishme për qytetin e qytetarët e saj për shkak se si ka qenë apo si unë e kam gjetur Rrugën “Ali Zeneli” ka qenë rrugë e pakalueshme, ujërat e zeza të derdhura në mes të rrugës, pa asnjë bazë të infrastrukturës, pa sistem fekal, pa ujëra të zeza, pa ndriçim, pa infrastrukturë. Të gjitha janë duke u bërë.

Rruga “Lah Nimani”, nuk është një rrugë 100 m, vetëm aq aty ku banon ti, z. Mujka, është edhe më e gjatë, është edhe më e gjatë është edhe pjesa tjetër, pjesa ku je ti duke banuar në Rrugën “Lah Nimani”, po, ka pasur infrastrukturë, ka pas ndriçim, ka pas sistem fekal dhe atmosferik, ndërsa pjesa tjetër e qytetarëve në Rrugën “Lah Nimani”, kanë qenë pa as edhe një bazë të infrastrukturës rrugore. Ka qenë pa sistem fekal, pa atmosferik dhe pa ndriçim. E kam bërë projektin detal teknik për Rrugën “Lah Nimani”, kanë fillu procedurat, kemi fillu me punimet, sot jemi në fund të punimeve në Rrugën “Lah Nimani”, pres që në afat shumë të shkurtë të përfundohet projekti dhe ta gëzojmë të gjithë qytetarët e Mitrovicës, jo vetëm një pjesë por të gjithë. Po flasim për midis të Qytetit të Mitrovicës, ato lagje nuk kanë pasur ujë të pijes, sot e kanë një rrjet të ri të ujësjellësit. Kjo është duke u bërë prej meje, po prej meje, nuk e ke bërë, ne jemi duke e bërë. Flasim për Rrugën “Mbretëresha Teutë”, Një rrugë tjetër e rëndësishme së veçantë për Qytetin dhe qytetarët e Mitrovicës, ku kemi hartim planit detal teknik të kësaj rruge, e kemi bërë zgjerimin e saj, kemi krijuar hapësira të reja parkuese me afro dyqind parkingje të reja në Rrugën “Mbretëresha Teutë”, një rrugë, e cila ka qenë shumë e ngarkuar sa i përket parkingjeve publike në qytetin e Mitrovicës. Kemi bërë ndriçim publik, ka projekt detal teknik, ne e kemi bërë projektin, ne e kemi filluar, ne e kemi përfunduar edhe projektin. Sa i përket Rrugëve “Agim Ramadani -Katana”- “Bislim Bajgora”, është projekt në të cilën kemi filluar me hartimin e projektit detal teknik, kemi filluar procedurat, kemi filluar edhe me punime. Të gjitha këto rrugë, sot kanë sistem kabllor nëntokësor, sot kanë rrjet të ri të fekalit, të atmosferikut, kanë të gjitha standardet e fundit që i nevojiten infrastrukturës rrugore qoftë në rrugën Bislim Bajgorë, qoftë në Rrugën “Agim Ramadani -Katana”, qoftë në rrugët “Lah Nimani” dhe “Ali Zeneli”, qoftë në Shesh, qoftë rrugën e Shipolit, të gjitha me një infrastrukturë rrugore të kohës së fundit. Ura te liqeni! Po, edhe ura te liqeni i kemi filluar të gjitha procedurat, ura sot është duke shkuar drejt përfundimit, pra në afat shumë të shpejtë edhe do të përfundohet. Sa i përket pyetjes së z. Muja projektet për Zasellë, Bajgorë, Shipol më herët pyeti edhe për ujësjellës, drita. Po, z. Muja. Bajgorën e kam gjetur me nevojë shumë të madhe për trajtim të rrugëve në Bajgorë, në Rashan, në Tërstenë, në Mazhiq nëpër shumë pjesë të Shalës, një pjesë prej tyre kemi punuar dhe ju kemi dalë në ndihmë atyre banorëve të atyre zonave. Po flasim për rrugën kryesore që i kemi lidhur tri fshatrat Mazhiq, Rashan, Tërstenë, po flasim për rrugën në Bare dhe shumë rrugë të tjera të cilat i kemi të planifikuara në këtë buxhet dhe presim të lidhim kontratat. Znj. Elidiana e bëri një pyetje shumë të qëllueshme, shumë me vend për mirëmbajtjen e Liqenit akumulues, po, ke shumë të drejtë ne i kemi planifikuar, e kemi blerë një mjet motorik i cili është për kujdesin dhe mirëmbajtjen e Liqenit akumulues, po, flasim për nivelin e pastërtisë së ujit. Sot liqeni mirëmbahet dhe pastrohet me mjet motorik specifik i cili është për mirëmbajtjen e liqeneve në gjithë botën, nuk pastrohet më në mënyrë siç është pastruar në të kaluarën, a është e mjaftueshme, çdo herë ka hapësirë dhe mundësi për më mirë edhe më shumë. Të falënderoj për pyetjen! Do të mundohemi të rrisim kapacitetet në mirëmbajtjen, qoftë në Liqenin akumulues dhe në çdo pjesë tjetër ku ka hapësira gjelbëruese dhe parqe të tjera.

Farku Mujka: Drejtor, as rruga e Shipolit, as Rruga “Mbretëresha Teutë”, as Rruga “Lah Nimani” nuk kanë projekt, dita-ditës janë ndërruar, nuk jetoj në Prishtinë, unë këtu jetoj. I ke ndërruar trotualet në Rrugën

“Mbretëresha Teuté” herë në atë anë i ke bë 5 m, 6 m, mandej pas një jave i ke ndërrua këndej. Ky rregullim shenjzëzim horizontal, të përgëzoj, boll kam shëtitur gjithkrah kësi ide kreative nuk kam pa. Edhe e dyta, a bën me tregu që kjo fontanë kur është projektua, kush e ka projektuar, kush është për tu paguar dhe kur e kena votu?

Granit Tmava: Zoti Mujka, edhe një herë po kthehem dhe po t'i përsëris, qoftë as rruga e Shipolit, Rruga “Mbretëresha Teuté”, Rruga “Lah Nimani” qoftë rruga “Ali Zeneli”, të gjitha kanë projekt detal teknik. Sa i përket fontanës në Qytet, në shesh, bën pjesë tek rregullimi i Shesheve “Adem Jashari”, “Mehë Uka” dhe “Isa Boletini”. Rregullimi i sheshit e ka të paraparë edhe rregullimin e dy fontanave, që janë në Qytetin e Mitrovicës, në mes të Qytetit. Janë duke u punuar, janë duke shkuar drejt përfundimit dhe pres që shumë shpejt të gjithë qytetarët e Mitrovicës do të mund t'i gëzojnë të mirat që janë duke u bërë për ta dhe për Mitrovicën.

Ekrem Sadiku: Është pak jashtë Raportit, po ka bëjë me një rrugë me të cilën është i njoftuar edhe Nënkryetari edhe ju, ka të bëjë me rrugën e cila është dëmtuar në lagjen Xhafa në Bare që vazhdimisht kam marrë përgjigjen që është lënda në OSHP, çka do ndodhë, a do ta shtroni atë, çka do ndodhë me atë rrugë? Sepse për momentin është e pakalueshme.

Granit Tmava: Riparimin dhe rregullimin e pjesës së dëmtuar të asfaltit, e cila qenka në Bare do ta kemi parasysh dhe do të ndërhyhet në momente sa më të shpejta që ata banorët që do të jenë në Bare, të kenë një trajtim sa më të mirë.

Naser Muja: Drejtor, te shenjzëzimi horizontal dhe vertikal, këtu 3000 po thotë shteg për biçikleta tek Liqeni, Çka keni bë me këto, unë nuk e di prej që janë lyster në fillim, kur e kemi vendosë ne më aty asnjë kilogram bojë, nuk u qitë. Çka keni mendu me këtë a mundesh me na e shpjegu?

Granit Tmava: Tek mirëmbajtja dhe tek shenjzëzimi horizontal dhe vertikal, kemi bërë shenjzëzimin e rrugëve ku ka qenë e nevojshme, e kemi bërë edhe tek rasti në fjalë, ku ju jeni duke pyetur tek Liqeni akumulues është bërë shenjzëzimi i asaj rruge.

Armend Begu: Një pyetje për drejtorin, a është i vetëdijshëm që e ka situatën ma keq në trotuare ose sa në rrugë? Për me qenë më konkret, më shumë ke vetura në trotuare sesa në rrugë, drejtor.

Hamdi Hasani: Përhëndetje të nderuar kolegë e kolege, me të vërtetë me dëgju për këto çështje, për këto rrugë dikë që nuk është i profesionit nuk më kishte ardhur kurrfarë çudie, mirëpo fjalët e kolegut, i cili është inxhinier i ndërtimtarisë kur flet për rrugë të tilla, nuk e din gjendjen, është edhe pak çudi për mua. Këto rrugë të gjitha punohen qysh e kemi pa edhe në projekte krejt me nivel më të lartë të standardit evropian, ku vendoset gjithçka nën tokë gjithçka vendoset tamam qysh duhet, me kriteret më të larta dhe kolegu si inxhinier i ndërtimtarisë thotë se kjo është ashtu, kjo është kështu.

Pasi nuk kishte diskutime tjera kalohet në pikën e radhës.

### **Pika 13**

Kryeseja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Në pikën pyetje dhe përgjigje, brenda saj është edhe pika e informatës për vërshimet.

Ekrem Sadiku: Atëherë, e nderuar Kryesuese, meqë jena de facto të dy pikat, pe filloj fillimisht diskutimin në lidhje me një pyetje konkrete që ka të bëjë me Drejtoreshën e Arsimit. Çka është ka ndodhë me arsimin në Komunën e Mitrovicës? Unë e kam pritë që sot do ta kemi para vetes raportin për fillimin e vitit kalendarit, se si ka filluar, cilat janë mungesat, cilat janë problemet në shkollat e Komunës së Mitrovicës? Pyetja konkrete që ke çka është kanë ndodhë me arsimin në Komunën e Mitrovicës ka të bëjë me mungesat e shumta të mësimdhënësve nëpër shkolla. Sa për informatën tuaj, le të hulumtohen këto dhëna, sepse i kam marrë nga mësimdhënësit nëpër shkollat e Mitrovicës, mirëpo për opinionin duhet me i specifiku rend me rend, një nga një. Ka mungesë mësimdhënësi për lëndën gjuhë shqipe në SHFMU “Musa Hoti” paralelja në Frashër. Ajo çfarë është shqetësuese, të nderuar kolegë, është se në këtë shkollë mungesë mësimdhënësi për gjuhën shqipe ka pas për tërë vitin e kaluar kalendarik. Çka do të thotë që klasat 6, 7, 8 dhe 9 kanë pasur mungesë për me dëgjuar dhe me mësuar nga kjo lëndë dhe ata nxënës iu kanë nënshtruar testit në fund. Mungesë mësimdhënësi për lëndën gjuhë gjermane, në po të njëjtën shkollë, mungesë mësimdhënësi në lëndën gjuhë shqipe në “Avdullah Shaban”; mungesë mësimdhënësi në “Mehë Uka” në Bajgorë për lëndën e gjeografisë, këtë lëndë është duke e ligjruar mësimdhënësi ose mësimdhënësja e historisë, në Rahovë ka mungesë mësimdhënësi të

gjeografisë, në Trepçë ka mungesë mësimdhënësi të gjeografisë dhe të artit figurativ, ndërsa në shumicën e shkollave të Shalës mungojnë dhe edukatorët për nxënësit para fillore. Në shkollën “Harun Beka” në Gushavc, mungesë për gjuhë gjermane, në “Fazli Grajçevci” dy mësimdhënës për kimi dhe edukatë qytetare mungojnë, në “Shemsi Ahmeti” mungon mësimdhënësi për gjuhë shqipe. Ju lutem, këto informata edhe një herë po e sqaroj që i kam marrë nga mësimdhënësit që punojnë nëpër këto shkolla, andaj, kërkesa ime është që drejtoresha përpos një raporti për fillimin e vitit kalendarik, njëkohësisht dhe të përgjigjet në këto pyetje, Sepse, sado që juve ndoshta nuk ju duket shumë më rëndësi ka të bëjë me humbje të orëve të mësimi dhe kjo për këtë çështje është dashur dikush me dhënë llogari. Një vit mos me u mbajt lënda gjuhë dhe letërsi shqipe, këtë rast gjuhë shqipe dhe të mos japë askush llogari, kjo është e tepërt.

Drita Kadriu: Sigurisht që nuk i kemi përditësua të dhënat dhe informatat të cilave iu jeni referuar dhe më lejoni t’ju njoftoj që në të vërtetë ka vështirësi në rekrutim të personelit siç është gjuha gjermane e cila tani e dy vite në mbarë Kosovën po has në vështirësi për shkak të mungesës së kuadrit të kualifikuar, por edhe të kuadrit i cili kish mund me ofru shërbimin e mësimdhënies së gjuhës gjermane me kurse apo një kualifikim të përafërt. Ka disa drejtorë shkollash që nuk dinë me menaxhua, e po më vjen keq se këtu duhet me qenë edhe tjetër kush me ndëgju, edhe orët e veta në Frashër nuk i mban. Ju e dini që Rregullorja për rekrutimin e stafit të Arsimit ka hy në fuqi diku në fund të gushtit, dhe andaj ka shkaktua vështirësitë në rekrutimin e pozitave të cilat kanë qenë të planifikuara. Pavarësisht kësaj Rregullorja është shumë pozitive, sepse krijon mundësi që rekrutimi të bëhet për zëvendësime me afat shumë më të shkurtër, me 7 ditë konkurs dhe kjo e ka lehtësuar procesin e rekrutimit. Përndryshe, veç po kam qejf me u thënë, se në vitin 2020 investimet në arsim kanë qenë 30,000 € ndërsa ju sot e keni parë buxhetin, startojmë plot. Kjo çështje e rekrutimit është pasojë e ndërrimit të strukturës funksionale, dhe që është ligji, i cili është shoqërua me përmirësimin e akteve nënligjore, udhëzimeve administrative dhe rregullativave tona, tani janë plotësua dhe sigurisht që ka me qenë shumë më lehtë për çdo kërkesë. Ne e kemi planifiku gjithashtu që këtë vit po i rekrutojmë edhe asistentët për fëmijë me nevoja të veçanta, edhe psikologët, se ka qenë kërkesa e deputetes z. Xhyljeta.

Kushtrim Zeneli: I pata disa pyetje për Drejtorinë e Arsimit, mirë, përgjatë diskutimit i gjeta ato pyetje tek drejtoresha, kam edhe një pyetje për Drejtorinë e Arsimit dhe një kërkesë ose pyetje për Drejtorinë e Emergjencave. Munden këto përgjigje edhe me shkrim me mi jep, e kam pyetjen për konkursin për drejtor të shkollave të mesmet ulëta, i kemi dy Shkolla të Mesmet Ulëta, po flas për shkollën Shaban Idrizi në Zhabar edhe shkollën Musa Hoti, njëri prej tyre ka qenë drejtor i Arsimit, ndërsa tjetra ka qenë drejtoresha e Shkollës Shaban Idrizi në Zhabar. Është një drejtoreshë e cila ka marrë edhe mirënjohje, e njëjta në bazë konkursit nuk është pranuar me arsyetimin se nuk i plotën kushtet. Unë nuk e di drejtoreshë me na shpjegu pak qysh një drejtor nuk i plotëson kushtet edhe vazhdon me qenë ende ushtrues detyre, kur dihet fakti se këta dy drejtorë shkollave, njëri ka qenë drejtor i Arsimit dhe tjetri, një drejtor me performancë, e kam fjalën për Drejtoreshën Saranda Ademin. Ndërsa për Drejtorinë e Emergjencave kam një pyetje, ndoshta një kërkesë bëhet fjalë për një biznes, i cili ka pësua një fatkeqësi. Biznesi është në emër të zonjës Kadire Sadriu, është biznes familjar, i krijuar me shumë mund dhe sakrificë me kredi. Për shkak të një fatkeqësie që e ka pas, biznesi tash është jashtë funksionit. është bë një kërkesë me 19 korrik 2024, ndërsa me 22 gusht 2024 iu është kthye përgjigjja që nuk ka mjete të mjaftueshme. Kisha me kërk drejtor që sipas mundësive ta ndihmoni, personi në fjalë nuk kërkon vetëm mjete financiare, kërkon edhe mjete të ndërtimit, biznesi është marrë me ushqime tradicionale.

**Mbledhja përfundoi punimet në ora 13:30 min.**

**Mitrovicë**

**Procesmbajtës:**

**Kryesuesja e Kuvendit**

**Afërdita MAXHUNI**

**Vesa BROJA**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	23.10.2024
REFERENCË:	Nr. 02-670/01-0069646/24
PËR/ZA/TO:	Znj. Vesa Broja – Kryesuese e Kuvendit Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bedri Hamza - Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	<b>PROPOZIM-VENDIM</b> Për shpalljen e konkursit ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale, në nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 2 dhe 4 të Rregullores Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë, Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

**PROPOZIM-VENDIM**

**Për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025**

- Me këtë propozim-vendim propozohet të SHPALLET Konkursi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025.
- Sipas pikës 1 të këtij propozim-vendimi propozohet të ndahen \_\_\_\_\_ bursa për studentë në shumë mujore prej shtatëdhjetë (70) €, të cilat ipen për periudhën kohore nga 1 tetori deri më 30 qershor.
- Nga numri i përgjithshëm i ndarjes së bursave, \_\_\_\_\_ bursa do t'u ipen studentëve nga komunitetet që jetojnë në Komunën e Mitrovicës, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me konkurs, respektivisht Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
- Kriteret për realizimin e së drejtës për bursë përcaktohen në bazë të Rregullores Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
- Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave formohet Komisioni nga Kuvendi i Komunës në përbërje prej 5 anëtarësh, 3 prej të cilëve zgjidhen nga anëtarët e Kuvendit dhe 2 nga ekzekutivi:
  - \_\_\_\_\_
  - \_\_\_\_\_
  - \_\_\_\_\_
  - \_\_\_\_\_
  - \_\_\_\_\_
- Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë kërkesat, të bëjë vlerësimin e tyre duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me konkurs dhe në harmoni me Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
- Studentët që fitojnë bursën do të lidhin kontratë që nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i bursës.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Komisioni i formuar me pikën 5 të këtij vendimi.
- Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	23.10.2024
REFERENCË:	Nr. 02-020/09-0069650/m
PËR/ZA/TO:	Znj. Vesa Broja – Kryesuese e Kuvendit Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa Anëtarët e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Bedri Hamza – Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	<b>PROPOZIM-VENDIM</b> Për formimin e Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); nenet 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 73, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenin 9, të Rregullores Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë; Kuvendit të Komunës i propozoj të sjell këtë:

**Propozim-vendim**  
**Për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave**

- I propozohet Kuvendit të Komunës të formojë Komisionin e Ankesave për ndarjen e bursave, në përbërje prej pesë anëtarëve: dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës, dy anëtarë i propozon Kryetari nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile.
  - \_\_\_\_\_ - anëtar i Kuvendit,
  - \_\_\_\_\_ - anëtar i Kuvendit,
  - \_\_\_\_\_ - nga ekzekutivi,
  - \_\_\_\_\_ - nga ekzekutivi dhe
  - \_\_\_\_\_ - nga shoqëria civile.
- Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë ankesat, lidhur me konkursin për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me konkurs dhe në harmoni me Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
- Komisioni ka tridhjetë (30) ditë kohë nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave, të marr vendim lidhur me ankesën dhe të njëjtin t'ua dorëzoj me shkrim secilit parashtrues të ankesës.
- Vendimi i Komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Komisioni i formuar me këtë vendim.
- Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës**  
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E MITROVICËS - OPŠTINA MITROVICA

02 02-352/05 - 0067249/24

Mr./Titulli: \_\_\_\_\_  
